



VIZIONI

BERATI I LASHTË, QYTET I TRASHËGIMISË KULTURORE BOTËRORE, ME NJË KOMUNITET QË I GËZOHET ZHVILLIMEVE HARMONIKE DHE MUNDËSIVE TË BARABARTA, NJË QENDËR E TURIZMIT NDËRKOMBËTAR, ME EKONOMI DINAMIKE TË MBËSHTETUR NË AGROBIZNES DHE ARTIZANAT TË KONSOLIDUAR.

MISIONI

OFRIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE QYTETAREVE DHE PERDORIMI ME DOBI , FRYTSHMERI DHE TRANSPARENCE TE FINANCEVE VENDORE ,NE PERPTHJE ME PROGRAMIN E ZHVILLIMIT VENDOR, RAJONAL SI DHE PRIORITETE E QEVERISE DHE STRATEGJISE KOMBETARE PER ZHVILLIM DHE INTEGRIM.



PERMBAJTJA

MESAZHI I KRYETARIT TË BASHKISË BERAT PËR BUXHETIN E VITIT 2015

KAPITULLI I

PERFORMANCA FINANCIARE E BASHKISE BERAT

- A. Situatat makroekonomike dhe ndikimi në ekonominë tonë.....
- B. Zhvillimet fiskale gjatë vitit 2014.....
- C. Partneritete , sponsorizime, marrëdhënie me donatorët.....
- D. Turizmi – prioritet i zhvillimit lokal.....

KAPITULLI II

ANALIZA E REALIZIMIT TË TREGUESVE TË BUXHETIT

- A. Informacion i përgjithshëm i buxhetit të vitit 2014.....
- B. Struktura financiare e vitit 2014.....
- C. Analiza e realizimit të planit të të ardhurave.....
- D. Analiza e realizimit të planit të shpenzimeve korrente.....
- E. Analiza e shpenzimeve sipas programeve buxhetore.....
- F. Investimet publike
- G. Auditimi- instrument i rëndësishëm për menaxhimin financiar dhe kontrollin.....

KAPITULLI III

PLAN BUXHETI I VITIT 2015

Informacion i përmbledhur plan buxhetit të vitit 2015

- 1. Të ardhura nga burime kombëtare.....**
 - 1.1 Transferta e Pakushtëzuar nga Buxheti i Shtetit.....
 - 1.2 Transferta të Kushtëzuara nga Buxheti i Shtetit.....
 - 1.3 Fondet për zhvillimin e rajoneve.
- 2. Te ardhurat e pushtetit lokal**
- 3. Plani i shpenzimeve ;
 - 3.1 Plan i shpenzimeve për njësitë shpenzuese.....
 - 3.2 Përdorimi i tepërës neto operative.....
 - 3.3 Alokimi i fondeve sipas programeve.....



MESAZHI I KRYETARIT TË BASHKISË BERAT FADIL NASUFI PËR BUXHETIN E BASHKISË 2015

E nderuar Kryetare e Këshillit të Bashkisë Znj.Valbona Zylyftari!
Të nderuar zonja dhe zotërinj Këshilltarë të Bashkisë!

Në këtë mbledhje të fundit të këtij viti, që përkon me festat e ndërrimit të viteve, ju uroj përzemërsisht :
Gëzuar Vitin e Ri 2015!

Si një mbledhje e rëndësishme,që analizon dhe miraton buxhetin faktik 2014, diskuton dhe aprovon P/Buxhetin e Bashkisë për Vitin 2015, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë, përcjell tek të gjithë ju të zgjedhurit dhe vendimtarët e Këshillit Bashkiak, tek bashkëpunorët e stafit,tek grupet e interesit,tek partnerët dhe tek i gjithë komuniteti i qytetit tone, mirënjohjen dhe vlerësimin e lartë për arritjet që kemi shënuar gjatë vitit 2014, për sfidat që kemi përballuar dhe për përmbushjen e misionit të qeverisjes vendore në funksionet që na ngarkon ligji dhe në realizimin e buxhetit të vitit 2014 që po mbyllim.

Analiza financiare e Bashkisë, në kuadrin e diskutimit të buxhetit, bazohet në sistemin raportues të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe do të japë një informacion mbi planifikimin, kontabilitetin, menaxhimin financiar të investimeve publike, të shërbimeve në komunitet dhe të shpenzimeve operativo-administrative që shoqërojnë dokumentin e buxhetit.

Në këndvështrimin tim, përtej shifrave dhe statistikave, do të nënvizoj risitë dhe ndryshimet që u reflektuan gjatë vitit 2014. Viti 2014 shënon frenimin e rënies ekonomike dhe dha sinjalet e rimëkëmbjes dhe të një performance pozitive e cila po progreson sipas parashikimevë dhe reformave te ndërmarra nga Qeveria dhe Mazhoranca e Aleancës për Shqipërinë Europiane.

Kjo rritje mbështetet në efektët pozitive të përmirësimit të klimës së biznesit, të zgjerimit të hapësirës së kreditimit të ekonomisë me financime nga tregjet ndërkombëtare, me shtimin e mundësive me fonde si përfitues të statusit të vendit kandidat për në BE etj. Padyshim që ritmi dhe pritshmëritë nuk janë maksimale,por të optimizuara, për shkak të nivelit të lartë të borxhit publik dhe të gjithë trashëgimisë negative financiare të mbartur ndër vite, dhe për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të biznesit dhe kontraktorëve e cila ka ndikuar në përmirësimin e likuiditetit të sektorit privat, por që ka frenuar trendin e investimeve publike.

Reformat e ndërmarra nga Qeveria Rama, kanë në fokus forcimin e ligjit, barazinë para ligjit për të drejtat dhe detyrimet si taksapagues, luftën e vijueshme dhe pa kompromis ndaj evazionit fiskal, reformat e rëndësishme tatimore, reformimin e mënyrës së përdorimit të fondëve publike me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të tyre. Të gjithë, në emër të ligjit dhe shtetit të së drejtes, në emër të standarteve demokratike europiane, jemi në një përballje të përditshme për të ndaluar dhe dhënë fund praktikave të abuzivizmit, të përfitimeve të paligjshme, të keqmenaxhimit të territorit, të zaptimit të hapësirave publike, të anashkalimit të detyrimeve për pagesat e taksave dhe tarifave dhe të sjelljes së shumë dëbitorëve si përfitues të paligjshëm ndaj shtetit. Tek kategoria e "përkëdhëlur" dhe e favorizuar ndër vite nga vjedhja dhe përfitueshmëria e paligjshme, këto masa shtrënguese lënë shije të hidhur dhe krijojnë kosto, por filozofia dhe angazhimi i Qeverisë për të ndërtuar shtet dhe jo për të qënë në pushtet, na kushtëzojnë për veprime energjike drejt çmontimit të një modeli dhe praktike korruptive dhe një pabarazie sociale, që i hapin rrugën një zhvillimi të qëndrueshëm dhe konsolidimit të autoritetit të ligjit dhe shtetit demokratik. Ndonëse ne një vit të vështirë social-ekonomik, ku efektet e krizës ndërkombëtare janë ende të ndikueshme për vendin tonë, ne ja dolëm që gjatë vitit 2014, të realizojmë një buxhet nga më të mirët dhe të balancojmë të ardhurat me shpenzimet.



BASHKIA BERAT

Pas gjashtë vitesh, Bashkia Berat eliminon borxhet e mbartura, shlyen likuiditetet e prapambetura dhe e fillon vitin 2015 me një gjëndje financiare të qëndrueshme dhe progresive. Impakt pozitiv pati transferata e pakushtëzuar e cila për vitin 2014 u rrit 22% në krahasim me vitin 2013 ose 36 milion lekë më shumë.

Të ardhurat vendore u realizuan në vlerën 200 milion lekë osë 87% të planit dhe shënojnë konsolidim në tërësinë e zërave të burimeve vendore.

Bashkia, në buxhetin e vitit 2014, nuk realizoi të ardhurat e planifikuara nga taksa e ndikimit në infrastrukturë ,për shkak të shpalljes së moratoriumit dhe bllokimit të lejeve të ndërtimit nga Qeveria.

Së bashku me mungesën e të ardhurave të planifikuara nga legalizimet, të cilat po bëhen falas u krijua një defiçit prej 6 000 0000 Lekë.

Ende ka rezerva dhe shkaktohen humbje në buxhet nga mosvjelja sipas vlerës dhe sipërfaqes së pronës të taksës së pasurisë, defiçit që krijohet nga mosrregjistrimi përfundimtar i ndërtesave dhe pronave në ZVRPP, nga mungesa e azhurnimeve dhe mungesa e një modeli eficient që identifikon, çertifikon, takson dhe kontrollojnë të ardhurat e pasurisë. Viti 2014 shënon kthesën në fushën e projekteve dhe investimeve publike, ku nëpërmjet bashkëpunimit të Bashkisë me AADF dhë FZHR (Qeveria Shqiptare), qyteti i Beratit ka përfituar rreth 700 milionë lekë të reja investime.

Investimet kryesore janë përqëndruar në Qendrën e qytetit, duke e transformuar atë në një qendër rekreative multifunksionale dhe në një mjedis të favorshëm për biznesin, turizmin dhe bashkjetesën komunitare.

Bulevardi Republika dhe Sheshi Teodor Muzaka të financuar në vlerën 1.2 milionë \$ nga AADF dhe 47 milionë lekë nga Bashkia Berat, përfaqëson sot një model inspirues të zhvillimit urban bashkohorë.

Me fondet e Qeverisë shqiptare, nëpërmjet FZHR, përfundoi Shëtitorja përgjatë Lumit Osum dhe Loti i parë i Lulishtes në qendër të qytetit që, sipas vlerës së prokuruar kostojnë së bashku 250 milionë lekë. Ndërkohë, po me financim të FZHR, në vlerën 46 milionë lekë, Bashkia ka lidhur kontratën me operatorin fitues për projektin e fasadave në bllokun e Lagjes 22 Tetori.

Janë celur fondet dhe janë në proces prokurimi projektet :

1. Rikualifikimi dhe rikonstruksioni i Lulishtes në Qendër (Loti opsional) dhe suplementi i Sheshit Teodor Muzaka (Loti 3) në vlerën 60 milionë lekë.
2. Rikonstruksioni i Trotuarit, Parmakëve, Nriçimi dhe punimet inxhinjerieke të segmentit Ura e Varur Ura e Goricës në vlerën 59 milionë lekë.
3. Ndërtimi i Kullës së Sahatit, pranë Xhamisë së Sahatit në vlerën 4,9 milionë lekë.

Gjatë vitit 2014 u financuan nga Qeveria shqiptare ;

1. Rikonstruksioni i Shkollës Kristaq Capo në vlerën 35 milion leke
2. Rikonstruksioni i Shkollës Thimi Tani në vlerën 31.7 milion leke
3. Në zbatim të programit për kthimin e shkollave në qendra komunitare po investohet për ndërtimin e fushave sportive në Shkollën 28 Nëntori, Ajet Xhindole dhe Xhemal Çekini me një fond prej 10 milionë lekë.
4. Me financim të FSHZH, në bashkpunim të Bashkisë me DRKK, po përfundon restaurimi i plotë i Urës së Goricës me një fond prej 23 milionë lekësh duke e “çliruar” Urën si monument kulture nga funksionet transportuese të rrjeteve inxhinjerieke dhe nga aksidentimet dhe deformimet e shkaktuara ndër vite. Nëpërmjet ndërhyrjeve të mëtejshme në Lumin Osum Ura e Goricës do të shëndërrohet në një atraksion turistik elitare dhe do jetë një vepër arkitekturore e ekspozuar tërësisht.FZHR rezulton një skemë e suksesshme financimi, jo thjesht për nga vlera, por në radhë të parë edhe nga filozofia, ku misioni është të ndërtojme bukur,të jemi kreativë në investime,të kryejmë punë që e mbyllin ciklin dhe të realizojmë investime të qëndrueshme dhe afatgjata.



BASHKIA BERAT

Është kjo filozofi dhe përqsasje modeli që nis së pari nga cilësia e projekteve dhe hartimi i tyre nga studio profesionale dhe të kualifikuara.

Bashkia Berat ka bërë hapat e duhur dhe i ka paraprirë hartimit të projekteve. Me financim të AADF dhe prezencës së Komisionit Europian, Bashkia ka të gatshme si projekte zbatimi Unazën Perimetrale dhe Lotet Opsionale të qendrës së qytetit dhe rreth 14 projekte në Kala për rigjenerimin urban dhe për rikonstruksionin e rrugëve lidhëse të Kalasë me qendrën e qytetit.

Ashtu siç i kemi bërë të njohura në prezantimet publike, në dëgjesat me grupet e interesit dhe në Forumin Urban që realizuam më 04 dhjetor 2014, Bashkia Berat ka gati projekte madhore për Unazën e Qytetit, Sistemimin e Lumit Osum, Rrjetin e Ujssjellës Kanalizimeve, Përpunimin e Mbetjeve Urbane si dhe shume projekte të tjera të zhvillimit urban që do të prezantohen në Buxhetin e 2015!

Gjatë vitit 2014, Berati ka qënë epiqëndër e disa eventeve ndërkombëtare, kombëtare e rajonale, të cilat kanë ndikuar në gjallërimin e jetës kulturore, social- ekonomike dhe kanë dhënë impakt pozitiv promocional, në rritjen e turizmit dhe të aksesit të Beratit si destinacion vlerash dhe si qytet i trashëgimisë që mbrohet nga UNESCO. Statusi i Beratit në rrjetet e bashkëpunimit ndërkombëtar është përforcuar dhe Bashkia në bashkëpunim me institucionet e tjera të shtetit ka punuar për ta faktorizuar ndërkombëtarisht qytetin dhe ka aplikuar dhe realizuar projekte me karakter shkencor, kulturor, ekonomik, për çështjet e zhvillimit urban, të turizmit dhe të natyrës multifunksionale.

Duke vlerësuar performancën dhe seriozitetin e drejtimit dhe stafit të bashkisë, sot kemi një bashkpunim të admirueshëm me donatorët dhe prezencën e institucioneve ndërkombëtare në Shqipëri për projekte afatshkurtëra dhe afatgjata.

Gjatë vitit 2014 kemi programe dhe financime të realizuara nga AADF për projektet BID, nga TIKA për restaurimin e Xhamisë së Plumbit dhe të paisjeve të Qendrës Sociale për Shoqatën e Grave, të PNUD për projektin e Qendrës Sociale për romët dhe egjiptianët, të USAID, për qeverisjen vendore dhe çështjet e planifikimit urban, të BB për pilotimin e zbatimit të PPV, të KE për rigjenerimin urban të Qendrës Historike, të KFE për fillimin e fazës së dytë të programit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe përmirësimin e infrastrukturës bashkiake etj. Gjithashtu Bashkia Berat është perzgjedhur dhe është monitoruar si bashki pilot nga USAID, për studimin e mbetjeve urbane, nga Ambasada e Vëndeve të Ulta për prokurimet elektronike dhe luftën ndaj korrupsionit, nga MF Austrisë dhe MF Francës për menaxhimin financiar dhe transparencën etj.

Duke vlerësuar pozitivisht rezultatet e monitorimit dhe të performancës Bashkia Berat u përzgjedh ndër 5 (pesë) bashkitë që do të pilotohen në të gjithë komponentët, funksionet dhe programet që zbaton USAID për qeverisjen vendore.

Ky program është një mbështetje e fuqishme për bashkinë dhe do të ndihmojë në aksesueshmërinë e qytetit për përfitueshmëri shërbimesh, investimesh, standartesh dhe qeverisje vendore të suksesshme. Të gjitha këto janë piknisje e mbarë për vitin 2015 i cili starton me financa më të shëndetshme dhe me një pritshmëri të lartë investimesh publike dhe ndryshimi cilësor në jetën e qytetit dhe komunitetit.

Të nderuar këshilltarë,

Viti 2015 shënon një ndryshim historik për qeverisjen vendore, pasi do të zbatohet reforma e re territoriale dhe administrative dhe do të zhvillohen zgjedhjet e reja vendore. Bashkia e Beratit zgjerohet si territor duke u kthyer në një qendër të rëndësishme funksionale zhvillimi së bashku me Komunitat Sinjë, Velabisht, Otlak dhe Roshnik.

Harta territoriale, sipërfaqja e njësive së re dhe popullsia është si më poshtë :

1. Qyteti Berat me Sipërfaqe 23 km² dhe popullsi 63'022 banorë
2. Komuna Velabisht me Sip 930 km² dhe popullsi 11'663 banorë. Ka 11 fshatra



BASHKIA BERAT

3. Komuna Sinjë me Sip 1463 km² dhe popullsi 5'473 banorë. Ka 14 fshatra
4. Komuna Otlak me Sip 632 km² dhe popullsi 14'043 banorë. Ka 14 fshatra
5. Komuna Roshnik me Sip 818 km² dhe popullsi 3'961 banorë. Ka 13 fshatra.

Bashkia Berat do të ketë Sip 3,866 km² dhe popullsi 98,162 banorë dhe në përbërje do të jetë qyteti i Beratit me 48 fshatrat e Komunave të mësipërme. Zbatimi i reformës së re administrativo-territoriale do të kursejë buxhetit të shtetit rreth 6 miliard lekë shpenzime administrative si dhe do të çlirojë shumë fonde publike në favor të zhvillimit ekonomik lokal, duke eliminuar pabarazinë midis zonave më potencialë zhvillimi dhe atyre që rezultojnë si zona të varfëra. Ndarja e re administrative është sfidë e rëndësishme. Ajo do të shoqërohet me reforma të tjera dhe një paketë ligjore që demokratizon dhe rrit efikasitetin e qeverisjes, përmirëson kualitetin e administratës vendore dhe garanton mbulimin me cilësi shërbimesh në gjithë territorin e njësisë së re administrative. Buxheti i vitit 2015 garanton kalimin efektiv të kompetencave, përgjegjësi dhe të gjithë problematikave vendore nga të zgjedhurit aktualë tek të zgjedhurit e rinj, ku janë parashikuar masat e nevojshme, rolet dhe detyrat përkatëse të periudhës tranzitore.

Në këtë kuptim, buxheti 2015, garanton ekuilibrat financiarë dhe aktivitetin normal të funksioneve të bashkisë. Ndonëse miratohet si një buxhet vjetor, natyrshëm ai do të rishikohet pas zgjedhjeve vendore dhe njësisë së re administrative. Siç theksova edhe më sipër, Bashkia Berat në këtë proces transformues do të jetë Bashki pilot nën monitorimin e USAID, çka do e lehtësojë kapërcimin e vështirësive të kësaj reforme dhe do të kemi përfitueshmëritë e para nga implementimi i saj. Ne jemi të angazhuar dhe do të ushtrojmë gjithë vullnetin dhe përgjegjësitë tona për mbarvajtjen e këtij procesi dhe do të garantojmë një vitë buxhetor dinamik, me shërbime cilësore, me financa solide dhe me investime publike shumë herë se cdo vitë tjetër. Për vitin 2015, buxheti për Bashkinë Berat është 206 milionë lekë nga transfertat e pakushtëzuar që ka një rritje 5% në krahasim me vitin 2014. Për të dytin vit radhazi, Qeveria akordon një fond ekselent prej 5 milionë lekë grand për statusin e Beratit në UNESCO. Në transfertën e pakushtëzuar janë vendosur kriterë dhe tavane që ruajnë ekuilibrat e shpenzimeve duke kufizuar shpenzimet për pagat nga 15% që ishte në vitin 2014 në 10% në vitin 2015 dhe duke i dhënë përparësi rritjes së trendit të investimeve.

Buxheti 2015 parashikon që të ardhurat vendore të jenë të rritura 18,5% më të larta se viti 2014 dhe paketa fiskale nuk parashikon ndryshime në sistemin aktual të taksave vendore. Edhe këtë vit jemi të kufizuar dhe të bllokuar nga ligji për lejet zhvillimore dhe paketës falas të legalizimeve, çka do të sjellë të ardhura të munguara nga taksa e ndikimit në infrastrukturë që zë një peshë të ndjeshme në buxhet. Potenciali i fuqishëm i pronave, ndërtesave dhe pasurisë publike që ka qyteti dhe maksimalizimi i vjeljes së të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore nga çdo biznes dhe taksapagues është rezervë e konsiderueshme që rrit të ardhurat e buxhetit të bashkisë.

Për vitin 2015 të ardhurat vendore parashikohen të planifikohen 227 milion lekë. Duke respektuar ligjin e buxhetit dhe përmbushjen e detyrimeve dhe funksioneve që kryen bashkia, për vitin 2015 kemi në dispozicion një tepicë neto operative për rreth 74.4 milionë lekë, e cila do të përdoret për bashkfinancime, investime publike dhe shpenzime në funksion të rritjes së cilësisë urbane, të shërbimeve publike, dhe për plotësimin e standarteve në arsim, në shëndetësi, turizëm, çështjet mjedisore etj. Pësha kryesore e investimeve publike do të mbahet nga financimet e Qeverisë shqiptare nëpërmjet FZHR- së.

Bashkia Berat ka aplikuar me projekte sipas prioriteteve të miratuara në Strategjinë e Zhvillimit Social-Ekonomik dhe në Planin e Investimeve Kapitale dhe do të realizojë disa nga këto projekte me financim të FZHR-së dhe Donatorëve. Ne do të bashkëfinancojmë 50% të kostove për hartimin e 5-8 projekteve të zbatimit, sipas marrëveshjes me studiot e përzgjedhura dhe financuara nga F.SH.ZH-se, dhe këto do të jenë projektet që do të aplikohen për financim nga fondet e FZHR-së.



BASHKIA BERAT

Qeveria shqiptare ka vënë në dispozicion 125 milionë \$ që do të menaxhohen nëpërmjet FZHR për projekte urbane në 61 Bashkitë e reja. Bashkia Berat ka në axhendën e financimeve nga FZHR projektet e mëposhtme :

1. Vazhdimimi i Loteve Opsionale të Qendrës së Qytetit dhe Unazës Perimetrale
2. Rruga Stadiumi i Vjetër-Stadiumi i Ri dhe Sheshi para Stadiumit Tomorri.
3. Rikualifikimi Urban, Rikonstruksioni i Trotuarevë, Unazës Perimetrale dhe Lulishtes ne Lagjen Dëshmorët e Kombit.
4. Rikualifikim Urban dhe Rikonstruksion i Sheshit Harmonia Fetare (Ish Axhensia)
5. Rruga Muzak Topia (Ish Ushqimore-Kala)
6. Rikualifikim Urban dhe trajtimi i Fasadave në segmentin Hyrja e Beratit Ura e Goricës
7. Projekti i Rikonstruksionit të Stadiumit të Vjetër dhe trajtimi i tij si qendër sportive multifunkionale.
8. Hartimi i projektit për trajtimin urban të ishullit brenda Lumit Osum në Segmentin Ura e Varur- Hotel Tomori
9. Godina e Re e Bashkisë Berat.

Ndërkohë nga ARSSH-ja, do të kryhet investimi për rikonstruksionin e Rrugës Qendra e Uznovës-Çezma e Thatë. Si projekt ndërvendor është aplikuar pranë FSHZH-së, për ndërtimin e Unazës së re të qytetit, projekt i cili është në negociatë edhe me Kompaninë kineze Synohidro me kreditim dhe do të aplikojmë edhe ofertat me konçension për këtë Bay -Pass dhe Sistemimin e Lumit Osum. Nga fondet për arsimin do të synojmë restaurimin e dy shkollave (1 Maji dhe Xhemal Çekini) si dhe ngritjen e komplekseve sportive në disa shkolla të qytetit. Me EKB është lidhur kontrata e ndërtimit të dy pallateve për të pastrehët dhe me MZHUT do të realizohet projekti për 25 banesat e komunitetit Romë.

Në muajin Shkurt 2015 do të fillojë zbatimi i projekteve të financuara nga KFE, në Zonën e Ish Pjeshkores dhe Lagjes 30 Vjetori për rrjetin e ujsjellsit, vendosjen e matësave dhe përmirësimin e infrastrukturës në këtë zonë. Investime inkurajuese do të realizojë edhe sipërmarrja private për biznese prodhuese hoteleri, objekte tregëtare etj. Edhe institucionet publike si SHAUK, DRSHK AUTOMJETVE, etj do të ndërtojnë zyrat e reja sipas standardeve bashkohore. Shërbimi i pastrimit dhe i përpunimit të mbetjeve urbane do të fillojë të modernizohet nëpërmjet një bashkpunimi të sipërmarrësit me partnerë të huaj duke realizuar skemën e ndarjes në burim të mbetjeve në dy rryma dhe riciklimin e tyre në lantfilld.

Jemi optimist se në vitin 2015 investimeve publike në Berat do të shtohen edhe financimet e BB për zhvillimin urban dhe të infrastrukturës bashkiake. Do të vazhdojmë bashkpunimet me AADF për 4 komponentët e marrëveshjes kuadër duke synuar projekte në zonën historike.

Me fondet e Bashkisë do të mbulojmë kostot e partneritetit ,kostot e hartimit të projekteve që do financohen nga FZHR, si dhe do të financojmë projektin e nisur në Lagjen Çlirim dhe hapësira të tjera urbane që kanë emergjencë përmirësimin e infrastrukturës. Gjithashtu do të mbështesim me fonde edhe eventet e rëndësishme të vitit 2015 si dhe financimin e veprave të artit që janë pjesë e rëndësishme e përjetësismit të vlerave dhe detyrim i plotësismit të vakumit që ka qyteti në këtë fushë.

Për gjithë situatën optimiste që kemi dhe për konkretizimin dhe jetëzimin e projekteve që synojmë të realizojmë kërkoj mbështetjen e Këshillit Bashkiak për diskutimin, debatin konstruktiv dhe miratimin e Buxhetit 2015.

Me konsideratë dhe me besim në mbështetjen tuaj!

Fadil NASUFI

KRYETAR I BASHKISË BERAT



KAPITULLI I

PERFORMANCA FINANCIARE E BASHKISE BERAT

Situata makroekonomike dhe disa tregues te ekonomise tone

Viti 2014 shënon vitin në të cilin ekonomia ka hyrë në një fazë rimëkëmbjeje, krahasuar me vitin e kaluar, e në përputhje me parashikimet. Tregues të ndryshëm dëshmojnë për një performancë pozitive të ekonomisë gjatë vitit 2014. Rritja ekonomike pritet të rimëkëmbet gradualisht në 3% në vitin 2015, e më pas të arrijë 4% në vitin 2016 dhe 4.5% në vitin 2017. Referuar Relacionit të Projekt Buxhetit të vitit 2015 të Ministrisë të Financave, rritja ekonomike mbështetet:

- ✚ në efektet pozitive të përmirësimit të klimës së biznesit,
- ✚ zgjerimit të hapësirës së kreditimit të ekonomisë nëpërmjet zëvendësimit të huamarrjes së qeverisë në tregun e brendshëm me financime nga tregjet ndërkombëtare,
- ✚ rritjes së investimeve publike (sidomos në sektorin e infrastrukturës).
- ✚ Po kështu pritet një rritje e aktivitetit ekonomik në vend si pasojë e marrjes së statusit të vendit kandidat për në BE.

Por, niveli i lartë i borxhit publik mbetet rreziku kryesor për arritjen e një rritje ekonomike të lartë e të qëndrueshme. Qeveria është plotësisht e angazhuar për të marre të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që të rivendosë borxhin publik në një trajektore rënese duke filluar që prej vitit 2015. Në vitin 2017 pritet që niveli i borxhit publik të jetë rreth 65.5% e PBB.

Faktorët kryesorë që do të mbështesin arritjen e objektivit të uljes së borxhit janë:

- (i) lufta e vijueshme dhe pa tolerancë ndaj evazionit fiskal;
- (ii) reformimi i mënyrës së përdorimit të fondeve publike me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të tyre;
- (iii) ndërmarrja e reformave të rëndësishme tatimore.

Investimet publike kanë qenë më të ulta se një vit më parë prej rreth 43% më pak, por prej buxhetit është kryer pagesa e detyrimeve të prapambetura të qeverisë ndaj biznesit, gje e cila ka ndikuar në përmirësimin e likuiditetit të sektorit privat në tërësi.

Sinjale pozitive kanë ardhur edhe prej tregut të punës, i cili në tremujorin e dytë të vitit regjistroi një rënie të normës së papunësisë në nivelin prej 17.7% nga 18.6% dhe një rritje të punësimit total.

Treguesit financiar gjithashtu kanë pasur një ecuri pozitive. Kreditimit në ekonomi nga sistemi bankar është karakterizuar nga lehtësirat e kushteve të kreditimit dhe për pasojë ka pasur rritje të kërkesës për kredi. Sistemi bankar mbetet mjaft solid, likuid dhe fitimprurës.

Berati vazhdon të konsiderohet një qytet me të ardhura të pakta, me nivel të lartë papunësie, me zhvillim ekonomik të ulët, me pensione shumë të ulta dhe me probleme të tjera sociale e shoqërore.

Evident është fakti i lëvizjes së popullsisë nga qytetet e Beratit drejt qyteteve të mëdha. Në Udhëzimin Plotësues të Ministrisë të Financave nr. 3 datë 17.01.2014 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2014” shtojca nr.5, rezultoi që Bashkia Berat të jetë, sipas regjistrimit kombëtar të Gjendjes Civile me **63022 banorë**, nga 64570 që ka pasur në vitet 2011-2012.



BASHKIA BERAT

Qyteti i Beratit ka 16548 familje, ndersa numri i familjeve në skemën e ndihmes ekonomike që trajtohen me fondet e buxhetit të shtetit janë mesatarisht 926 trajtues për vitin 2014 (muaji i fundit rezultoi me 850 familje të trajtuara), 74 trajtues më pak se në vitin 2013, (janë trajtuar 1000 përfitues), 126 familje më pak se në vitin 2012 dhe 263 më pak se në vitin 2011.

Trajtuesit e ndihmes ekonomike për vitin 2014 të ndarë me rajone janë respektivisht si më poshtë: Rajoni Nr.1, 308 familje, Rajoni Nr.2, 288, Rajoni Nr.3, 255 familje, Rajoni Nr.4, 75 familje.

- Nga këto janë trajtuar me ndihmë të plote 860 familje, me ndihmë të pjesshme 66 familje
- Përfitues nga skema e ndihmes ekonomike 175 familje me kryefamiljare gra
- Përfitues nga skema e ndihmes ekonomike janë 59 familje të komunitetit rom.
- Kane përfituar ndihmë ekonomike 10 familje që kanë në përberjen e tyre persona me aftësi të kufizuara (PAK).
- Nga fondet e buxhetit të bashkisë janë trajtuar :
 - 19 familje si raste të vecanta me një fond për rreth 980 mijë leke, të cilat u perkasin grupeve me vulnerable që nuk përmbushin kriteret për të përfituar nga ligji i ndihmes ekonomike.
 - Nga këto 11 familje janë me kryefamiljare gra.

Përsa i takon masën e ndihmes ekonomike është mjaft e ulët kështu një familje përfiton mesatarisht në muaj 3367 leke, sasi e pamjaftueshme për të përballuar nevojat minimale.

Për vitin 2013 një familje ka përfituar nga skema e ndihmes ekonomike mesatarisht 4126 lekë në muaj, masë e pamjaftueshme për përballimin e nevojave jetësore.

Gjatë vitit 2014 bashkia ka trajtuar me fonde të Buxhetit 2265 persona me aftësi të kufizuara. (PAK).

Referuar disa të dhënave statistikore, të punësuar gjithsej llogariten 10902 persona, prej të cilëve në biznesin privat 6536, në sektorin shtetëror 4366, dhe 3589 në biznesin privat. Prej të cilëve në biznese vendase janë 3395, në firmat e huaja 459, në ndermarrje të përbashkëta 5 persona.

Niveli i papunësisë në Bashkinë Berat llogaritet të jetë ;

Forca efektive të afta për punë llogariten rreth 42000. Numri i punëkerkuesve të regjistruar është 2884. Ose 7 %. Ndersa me të korrigjuar me indekse të teprë niveli i papunësisë llogaritet rreth 12.6 %.

Punëkerkues për Beratin janë 2884 prej të cilëve femra 1210, ose shprehur në përqindje 42 % femra. Indeks ky me të ulët krahasuar me treguesin e qarkut për sa i përket punëkerkuesve femra. Punëkerkues që përfitojnë nga pagesa e papunësisë nga 152 gjithsej 78 janë femra ose 51 % e tyre.

Punëkerkues të tjerë në numër total 998 prej të cilëve 246 femra ose 25 % e tyre.

Oferta e punës në tregun e punës është e fokusuar me tendencë kryesore në fushën e konfeksionimit në profesionin e rrobaqepsisë apo dhe në fushën e konservimit.



Zhvillimet fiskale gjate vitit 2014

➤ **Rritja e te ardhurave**

Viti 2014 shënon një ndër vitet me realizimin më të mirë të të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore. Viti 2014 shënon vitin e dytë më të mirë për nga realizimi i të ardhurave. Rritje kanë pasur të ardhurat nga taksa mbi ndërtesat, nga tarifave vendore, sidomos tarifave nga familjet.

➤ **Shfuqizohet taksa vendore mbi biznesin e vogël.** Kjo taksë që mbledhej nga administrata tatimore vendore si dhe tatimi mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël që mbledhej nga administrata tatimore qendrore zëvendësohen me një tatim të vetëm, **tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.**

➤ **Taksa mbi ndërtesën ndryshon nivel** duke u rritur dhe duke tentuar që të përditësohet me ndryshimet që kanë ndodhur gjatë këtyre viteve. Gjithashtu informacioni që do na jepet nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në lidhje me të dhënat e regjistrimit elektronik të pasurisë do të mundësojë që të rriten të ardhurat nga taksa e pasurisë.

➤ **Hiqet kufizimi për vendosjen e tarifave vendore** në kufirin 10 për qind të nivelit tregues të taksës vendore të biznesit të vogël, kufizim i cili ka ndikuar në politikë bërjen e bashkisë e cila nuk ka patur diskrecionin e duhur për vendosjen e masës së tarifave vendore për shërbimet publike të pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit publik në përputhje me koston e ofrimit të këtyre shërbimeve.

➤ **Eshte viti i dyte i faturimit Te tarifave Te familjes së bashku me faturën e ujit te pijshëm,** dhe vjelja nga Ndermarja e Ujesjelles –Kanalizimeve. Rezultatet e kesaj menyre jane pozitive në rritjen e të ardhurave. Pavaresisht faktit qe eshte rritur baza e tatushme, ka vend per sakesimin e listave te familjeve (klienteve te ujesjellesit, dhe familjeve sipas rregjistrimit te Gjendjes Civile.)

➤ **Efekte fiskale ne tarifa** (per shkak aplikimit te paketes se re fiskale si dhe rritjes se arketimit nga agjenti tatimor Ndermarrja Ujesjelles Kanalizime) **çoj ne rritjen e mbullimit te koston me tarifat.**

Per vitin 2014 jane keto tregues:

- Mbulohet me tarifen e pastrimit qe paguajne biznesi dhe familjet 90% e koston se pastrimit.

- Mbulohet me tarifen e gjelberimit qe paguajne biznesi dhe familjet 58% e koston se gjelberimit. --- Mbulohet me tarifen e ndicimit publik qe paguajne biznesi dhe familjet 61% e koston se gjelberimit.

➤ **Shperndarja e pageses me këste** e tarifave të familjes, gjatë 12 muajve të vitit, lehtësoi pagesën e këtyre detyrimeve për familjarët.

✓ **Pezullimi i dhënies së lejeve të ndërimit** për qytetin e Beratit, në zbatim të vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit të datës 08.10.2013 çoi në mosrealizimin e të ardhurave nga ky burim shumë i rëndësishëm për financat vendore.

✓ Në kuadër të arkëtimit të të ardhurave **nga Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël** ku tashmë biznesi do të tatohet në bazë të fitimit nevojitet që biznesi i vogël të kryejë rregullisht **transaksione me dokumenta të rregullt** justifikues si rrjedhojë nga administrata tatimore nevojitet kontroll shumë më i rreptë.



BASHKIA BERAT

- **Përmirësimi i kapaciteteve për planifikimin** më të mirë të të ardhurave në kuadër të Programit Për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP), një program 5 vjecar i financuar nga USAID në të cilën Bashkia Berat është përzgjedhur si pjesë e programit nga një numër prej rreth 30 njësisish candidate. Në vëmendje të këtij programi do të jetë **veçanërisht informatizimi i sistemit të taksave , tarifave vendore dhe e financave** .
- Ne hartimin e paketës fiskale, dhe ne teresi të buxhetit vendor 2014 jemi asistuar nga specialist të USAID-it, pasi Bashkia Berat është Bashki pilot e përzgjedhur që në vitin 2013.

Partneritete, sponsorizime, marrëdhënie me donatorët- vlera të shtuara në Bashkinë Berat

Puna e Bashkisë Berat për ngritjen e projekteve të përbashkëta me partnerë të huaj është drejtuar në këto fusha:

1-Bashkëpunim me bashkitë Binjake

2-Bashkëpunim me organizatat dhe partnerët e huaj.

3-Rrjetet Nderkombetare

4-Ambasadat e huaja .

5-Projektet e Bashkimit Europian

Prioritare ka qenë gjetja e burimeve alternative të financimit për projektet e Bashkisë Berat dhe plotësimi shpeshherë i bashkefinancimit me burimet njëzore të Bashkisë .

Projektet me donatorë të Bashkisë Berat për vitin 2014

1-Histori suksesi ka qenë projekti BID bashkefinancim i Bashkisë Berat dhe AADF (**Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim**) . VKM nr. 918 datë 04.10.2013 “Për miratimin në parim, të marrëveshjes ndërmjet Bashkisë Shkoder, Korce, Berat, Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim dhe Keshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë , për zbatimin e projektit “Zone për zhvillimin e biznesit –ZZHB”, i hapë rrugë nënshkrimit të marrëveshjes midis 3 kryetarëve të bashkisë të sipërcituara, qeverisë shqiptare dhe presidentit të AADF. Në kuder të kësaj marrëveshje Bashkia Berat përfitoi projektin “Rivitalizimi i Bulevardit “Republika” dhe Sheshit “Teodor Muzaka”, projekt i cili u kurorëzua me sukses.

2-PNUD është organizata që mbështet për të pestin vit Bashkinë Berat , me mbështetjen për projektin për komunitetin ROM. Projekti në fushën sociale për rehabilitim infrastrukturë për popullatën Romë financohet nga PNUD dhe synon shtrirjen e shërbimeve në territorin ku aktualisht jetojnë Romët.

3-Organizata Turke për Zhvillim **TIKA** ka financuar restaurimin e Xhamisë së Plumbit dhe me tëj do të vijojë me dy xhami të tjera (Xhamia Mbret, Xhamia e Beqareve), duke i konsideruar jo vetëm si objekte religjioze por edhe si atraksione turistike dhe pika me interes.

4-**USAID** ka financuar projektin "Forcimi i Qeverisjes lokale dhe decentralizimi" , ku Bashkia Berat është përfituese në sektore të tilla si Ujesjellës - kanalizime, shërbimet publike, taksat dhe financat vendore, kryesisht me mbështetje në fushën e teknologjisë informative.



BASHKIA BERAT

5- **Unesco dhe Fondacioni Ballkanika** bashkefinancuan ne Mars 2014 eventin “Urat e Ballkanit flasin”. Aktivitete kulturore dhe ne fushen e trashegimise u zhvilluan ne Berat pergjate tre diteve, me prezencen e Drejtores se Pergjithshme te Unesco-s.

6- **Fondacioni Shqiptar- Amerikan ne Shqiperi** bashkefinancoi projektin “Kolonja e Arteve ne Berat” e cila u zhvillua ne datat 09-11 Tetor 2014, me prezencen e 52 artisteve , piktore dhe skulptore nga Shqiperia dhe Rajoni.

7-**Co Plan** eshte prezent ne Bashkine Berat me projektin per rehabilitimin ne infrastrukture per zonat informale ku banojne kryesisht popullate Rome dhe Egjiptiane. Projekti shtrihet ne harkun kohor 2014-2015.

8- **Ambasada e Izraelit** ne Shqiperi po financon rehabilitimin e pjesshem te Çerdhes nr.1 ne lagjen 30 vjetori.

9-**Organizata “Njerez dhe Ide”**, ne bashkepunim me donatore te tjere dhe me bashkefinancim te Bashkise Berat organizuan Festivalin MultiKulturor ne Berat me muajin Gusht, dhe do te organizojne eventet e festave te fundvitit pergjate 10 diteve ne muajin Dhjetor.

10- Bashkia Berat bashkefinancoi me donatore eventin “Jazz and Ëine” ne muajin shtator 2014.

11-Rajffesisen bank , Se pari: sponsorizoi ne shumen 300 000 leke Projekti “Urat e Ballkanit flasin” ne keto zera:

- a. Perktim simultan shqip-angliesht dhe shqip frengjisht per Konferencen Nderkombetare te mbajtur me daten 29.03.2014.
- b. Albume fotografike “Berati” te autorit Leon Cika 17 cope, Suvenire ikona druri “Burimi Jetedhenes” 24 cope , dhurata per personalitete te dhuruara ne eventin ne fjale.
- c. Materiale per piktoret per kolonine e artit.

Se dyti: Blerje fotokopje profesionale per administraten e bashkise ne shumen 286 000 leke.

12-Alfa Bank Albania sh.a.

Sponsorizim , ne kuader te ofrimit te sherbimeve ndaj komunitetit ,ne drejtim te permiresimit te mjedisve publike , (rikualifikimin e vepres skulpturore “ Ujesjellesi i Bogoves” ne sheshin Qendror “Teodor Muzaka”) ,ne shumen 205 000 leke.

13-Keshilli i Qarkut Berat, ne kuader te bashkepunimit me Bashkine Berat per vitin 2014,ka financuar per investime dhe aktivitete ne Bashkine Berat, ne objektet e meposhtme :

13.1 Rikonstrukcion & Asfaltim i rruges 5 Maji, Bashkia Berat ne vlere **2 199 240** lekë

13.2 Rikonstrukcion & Asfaltim i rruges Pjeshkorja, Bashkia Berat me vlere **7 532 451** leke

13.3 Punime ne fasaden e Zyres te Drejtorise Rjionale te Shendeteshise Berat ne vleren **1 849 855** leke

13.4 Punime riparimi dhe blerje pajisjesh per kompletimin e salles se bibliotekes ,“ Vexhi Buharaja“ **480 000** leke

13.5 Furnizim vendosje qivur me plake perkujtimore per deshmoret e atdheut **150 000** leke

13.6 Rikonstrukcioni i varrezave te deshmoreve Bashkia Berat (Lapidari) **324 000** leke



BASHKIA BERAT

13.7 Ndertim i muzeut te shkolles “ 22 Tetori”, Bashkia Berat **243 607** leke

13.8 Aktivitete te perbashketa ne kuader te festes se 70-Vjetorit te clirimit te Beratit **480 000** leke

13.9 Financime ne kuader te emergjencave civile ne ndihme te banoreve te qytetit te Beratit **200 000** leke

13.10 Financime ne kuader te festimeve te 70 vjetorit te clirimit te vendit **150 000** leke

13.11 Financime ne kuader te aktiviteteve me rastin e dites se mesuesit **55 000** leke

Financimet e renditura me siper te realizuara gjate vitit 2014 jane ne shumen totale **13 664 153** leke

14. **Intesa Sanpaolo Albania**, kontriboi , dhurim ne naryre 3 njesi kompjuterike per Bashkine Berat.

15. Shume i frutshem bashkepunimi me **“Save the children”** qe ka mbeshtetur financiarisht aktivitete te ndryshme, por edhe familje ne nevojte. Ne te njejten kohe jane mbeshtetur me **pagesen e cerdhes per 8 femije** (kryesisht rom e egjyptian) ne menyre qe nenes ti krijohet mundesia per te punuar. Jane pjesmares ne te gjitha rastet qe menxhohen nga NJMF me asistencen juridike dhe me ndihma ushqimore per familjet e femijve ne risk.

16. Bashkia Berat eshte partnere ne **Projektin “SIRECC” te PNUD** dhe si rezultat eshte ndertuar e funksionon **Qendra Multikulturore** per komunitetin rom e egjyptian. Ne kete Qender ofrohen sherbime arsimore si kopeshit per femije, konsultori i nenes e femijes si dhe klinike stomatologjike. Qendra sherben per organizimin e te gjitha aktiviteteve te komunitetit rom.

17. Bashkia Berat eshte duke bashkepunuar me CO-Plan per **projektin e “Permiresimit te kushteve te banimit** te komunitetit rom e egjyptian”. Nga ky projekt perfitues do te jene 25 familje qe do tu rikonstruktohen banesat.

18. **Aktiviteti me rastin e 8 Prillit –Dita nderkombetare e Romeve**. Nje bashkepunim i Bashkise Berat me UNDP, dhe fondacioni “Ndihme per Femijet “, kurrezoi me sukses aktivitetin me femijet rom dhe prinderit e tyre. Ky aktivitet kishte si qellim promovimin e vlerave kulturore te ketij komuniteti.

19. **Aktivitet me rastin e 1 Qershorit**. Ky aktivitet u krye ne ambjentet e Qendres Multikulturore me pjesmarjen e 70 femijve te moshes parashkollore, ne bashkepunim **NJMF, UNDP, NPF, DAR** e Bashkia Berat. Ishte nje aktivitet gjithte perfshires dhe sherbeu per promovimin e sherbimeve qe do te ofrohen ne Qender. Per 70 femijet pjesmarres u shperndane pako me mjete kancelarike.

20. **U organizua Kampi veror per periudhen 7 Korrik – 18 korrik**. Ne kete kamp moren pjese 70 femije (gjithe perfshirje) ,nga keta 15 rom .Ka qene nje veprimtari shume argetuese per femijet pjesmares. E financuar nga “Save the Children” e UNDP.

21. Bashkia Berat me bashkepunimin e donatoreve si **UNDP e “Save the Children”** arriti te siguroje paisjen me tekste shkollore per vitin arsimor 2014-2015 per 109 femije te arsimit 9 vjecar si me poshte:

- **UNDP perballoi 45 paketa** mesimore per femijet e shkolles “Shyqyri Lakra”, kryesisht te komunitetit egjyptian me fondin prej 130.000 mije leke.
- **“Save the Children” perballoi 27 paketa** mesimore per femijet e shkolles “Xhemal Çekini” per rastet e ndjekura nga NJMF. Me fondin prej 75.000 mije leke.



BASHKIA BERAT

- **Bashkia Berat perballoi 37 paketa** mesimore per femijet e shkollave te tjera 9 vjecare te qytetit ne fondin prej 100.000 leke.

21. Bashkia Berat , ne bashkepunim me EPER CENTER , realizuan projektin **“Shkolla ekologjike e qytetit tim”** (bashkia financoi 375 000 leke, ndertim fidanishte ne shkollat “1 maji” dhe “Xhemal Cekini”).


22. Ambasada e Izraelit ne Shqiperi dhuron nje fond per rikonstruksionin e pjesshem te Cerdhes nr 1 ne Berat, te cilen e frekuentojne rreth 80 femije te lagjen "30 vjetori". Punimet do te fillojne ne ditet ne vijim.

Turizmi – prioritet i zhvillimit lokal.

Sipas Agjencisë së Zhvillimit të Turizmit, **Berati është destinacioni kulturor i preferuar i turistëve që vijnë të vizitojnë Shqipërinë** për turizëm kulturor dhe natyror. Ne zyrën e Informacionit Turistik, për vitin 2014 janë ndërmarrë anketime të vizitorëve si dhe të bizneseve e komunitetit. Më poshtë janë rezultatet paraprake të anketimeve. Anketimet janë realizuar mbi një kampion prej 150 turistësh të përzgjedhur në mënyrë të rastësishme.

Të ardhurat kryesore nga turizmi vijnë kryesisht nga biletat e shitura në Kalanë e Beratit dhe në dy Muzetë Kombëtarë. Sektori privat ka pasur një rritje të konsiderueshme, sipas të dhënave nga shitja e biletave, rezulton se deri në Muajin Nëntor të vitit 2014 kanë ardhur 33.043 turistë, ndërsa në vitin 2013 numri i turistëve deri në muajin Nëntor ishte 22.046. Rritja e numrit të turistëve është me mbi 50% për këtë vit. (Sipas biletave të shitura në Kalanë e Beratit)

Mosha e turistëve që kanë vizituar Zyrën e Informacionit Turistik për vitin 2014, sipas statistikave turistët e grupmoshës 26-30 vjeç janë më të shumtë që vizitojnë qytetin në mënyrë të pavarur.



Gjinia e Turistëve që kanë vizituar Zyrën e Informacionit Turistik për vitin 2014. 62% e vizitorëve në bera kanë rezultuar se janë meshkuj, ndërsa pjesa tjetër femra.






Origjina e Turistëve të anketuar në Zyrën e Informacionit Turistik

Sipas kampionit të anketuar, turistët që kanë vizituar më tepër qytetin e Beratit janë Gjermanë, duke vijuar më pas me francezë, Italianë, Polakë, Anglezë, Hollandezë etj.

Grafiku nr. 1 : Origjina e Turistëve



Shërbimet Turistike

Akomodimi: Në vitin 2014 Berati ka 32 hotele dhe shtëpi pritëse, ndërsa disa të tjera janë duke u ndërtuar. Një sërë shtëpi pritëse janë hapur së fundmi në shtëpitë tradicionale të Mangalemit, Goricës dhe Kalasë.

Ushqimi dhe pijet. Janë gjithsej 29 restorante në qytetin e Beratit të cilat janë të orientuara kryesisht në drejtim të shërbimit të turistëve. Ato ofrojnë si kuzhinë tradicionale ashtu edhe kuzhinë ndërkombëtare, kryesisht Italiane.

Shërbimet turistike: Berati ka katër agjenci udhëtimi që operojnë kryesisht për dërgimin e turistëve vendas jashtë shtetit. Asnjë agjenci nuk shet aktualisht ture të organizuara në rajon megjithëse këto ture organizohen në bazë të kërkesave të çastit.



Problematika në Turizëm

Edhe këtë vit, një nga problemet kryesore në lidhje me turizmin ishte **transporti dhe aksesimi i kufizuar** për të mbërritur në qytet nga rrugët kombëtare. Megjithatë, rrugët Kombëtare që e lidhin qytetin me kryeqytetin, aeroportet dhe portet janë në përmirësim e sipër dhe vitin në vijim shumë prej tyre do të kenë pësuar përmirësim të dukshëm.

Me përmirësimin e rrugëve transportuese, Shqipëria dhe Qytetit i Beratit pritet të dalin nga statusi i tyre si Vend i Panjohur dhe rritja e numrit të turistëve pritet të jetë eksponenciale, duke zënë vendin e merituar pranë qyteteve më të vizituara në Ballkan si Budva, Ohri, Dubrovniku. Kjo rritje më së e pritshme, do të krijojë qytetit një nevojë që të planifikojë për hapësira urbane të cilat marrin parasysh akomodimin e turistëve dhe vecanërisht të mjeteve më të cilat ata udhëtojnë.

Ndërsa numri i restoranteve dhe hoteleve është rritur dukshëm dhe vijon të rritet, në qytet ngelet shqetësuese situata e **parkimit të autobusave**. Me fillimin e turizmit masiv që pritet të vërshojë shumë shpejt në Shqipëri, kërkesat e turistëve për vizita tejet të shkurtra do të jenë gjithmonë e më të mëdha. Nevojitet një parkim në lagjen Kala ku vetëm autobusat e një sholle mund të shkaktojnë bllokim si dhe një parkim në qytet, afër qendrës historike. Turet e mëdha planifikojnë vizita tejet të shkurtra dhe vizita e tyre duhet të jetë sa më efiçente nga pikpamja e kohës dhe për këtë arsye do të kërkohet një akses më mirë ndaj fluksit turistik në qytet.

Problematike të tjera në lidhje me turizmin dhe që kanë nevojë të adresohen janë: **zhvillimi dhe unifikimi i paketave dixhitale, faqet e internetit, aplikacione dhe media sociale**. Aktualisht ofrohen shumë faqe interneti por që nuk kanë standardin e duhur nga pikpamja e marketingut ku konkurrenca është gjithnjë e më lartë. Tjetër sfidë mbetet **menaxhimi i mbetjeve dhe ruajtja e mjedisit** gjatë fluksit turistik. Lagjet historike kanë nevojë për kosha, pastrim më të shpeshtë, tabela informuese si dhe hapësira rekreative për turistët dhe banorët. Nga pikpamja e bizneseve shihet një nivël i lartë i informalitetit. Në fushën e marketingut, qytetit i duhet një plan i **unifikuar marketingu**, festivale dhe evente vjetore të mirëstudiuara dhe të mbështetura në shtratin e traditës Beratase etj.

Problematika në Fushën e Trashëgimisë Kulturore

Në fushën e Menaxhimit të Trashëgimisë Botërore, problematike ngelet **moskoordinimi për funksionimin e Planit të Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore**. Plani ka nevojë të bëhet pronësi e komunitetit, duhet të mbështetet te komuniteti dhe për këtë arsye kërkon një partneritet të madhe me komunitetin. Ende është e vështirë që të kuptohet rëndësia e Planit të Menaxhimit. Moszbatimi i tij humb shumë sinergji me aktorë dhe faktorë në komunitet, në mjedisin e donatorëve, Qeverinë Shqiptare etj. Trashëgimia Kulturore nuk mund të menaxhohet më me financime të drejtëpërdrejta nga qeveria, pasi është shumë e kushtueshme. Për këtë arsye, shoqëria dhe komuniteti duhet të marrin **një rol parësor për të gjeneruar mbështetje** sa më të madhe në një grup sa më të madh individësh dhe palë interesi. është e nevojshme aktivizimi i komitetit për planin e menxhimit të trashëgimisë kulturore, nën drejtimin e DRKK-së Berat.

Në fushën e Trashëgimisë është e rëndësishme të bëhen studime për rijetëzimin e monumenteve dhe studime mbi kontekstin e njerëzve që jetojnë në banesat historike.



KAPITULLI II

ANALIZA E REALIZIMIT TE TREGUESVE TE BUXHETIT

A. Informacion i pergjithshem i buxhetit te vitit 2014

- Nga pikepamja e ekomomike-financiare viti 2014 shënojë rritjen e **Buxheti vendor në tërësi**. Nëse ne vitin 2012 buxheti vendor zinte 2.1% te PBB-se, ne vitin 2013 ai ze 2% , ndësa në vitin 2014 **Buxheti vendor zë 2.4% te PBB** (sipas Ligjit “Per miratimin e buxhetit te Vitit 2014, nr.185/2013.)
- Jane bërë pëmirësime në shpërndarjen e **Transfertes se pakushtezuar** per Njesite e Qeverisjes vendore dhe **ka rritje se saj** . Bashkia Berat perfiton nga transfertat 196 milion leke, nga 160 milion ne vitin 2013, pra, shtesa e transfertes ne vlere absolute eshte 36 milion leke, ose **22%** me shume.
- Jemi perfitues te Grandit prej 5 milion leke (te perfshire ne **Transferte**) **si Bashki pjese e UNESCO-s**.
- Te dhenat e popullsise jane marre nga **rregjistri kombetar i gjendjes civile** dhe jo nga Censusi. (shtojca nr. 5 e Udhzimit Plotesues te Ministrit te Financave “Per zbatimin e Buxhetit te vitit 2014”).
- Efektet e **paketes fiskale** dhane efekt pozitiv ne buxhetin e vitit 2014, duke rritur % e mbulimit te koston me tarifat.
- Per evidentimin e **borxhit e të detyrimeve** te prapambetura Ministria e Financave ka ndjekur një proces intensive te evidentimit, vleresimit dhe auditimit te borxhit. Ne kete konteks ne kemi kryer procedurat ne perputhje me kete orientim.
- Bashkia Berat fillon vitin buxhetor 2014 me **detyrime të mbartura** nga viti 2013, ne shumen **68.2 milion leke**, nga te cilat **30.8 milion leke** jane investime te perfundura dhe te pafinancuara sipas plan buxheti te vitit 2013.
- Buxheti i vitit 2014 kushtezoi perdorimin e **Teprices Neto Operative** qe i perkete investimeve te prokuruar ne vitin 2012 me vlere te plote, te perfunduar ne vitin 2013 dhe te pafinancuara, vlere pjesore te paperfshire ne buxhetin e vitit 2013.(më hollesisht trajtuar ne kapitullin perkates).
- Plan buxheti I vitit 2014 mbeshteti financiarisht ne shumen prej 44 760 000 leke, implementim in e projektit “**Rehabilitimi i Bulevardit kryesor “Republika” dhe sheshit “Teodor Muzaka”**”, pjese e Strategjise se Qytetit per Zhvillimin Social Ekonomik 2010-2020 te vendimuar ne Keshillin Bashkiak, si pjese e bashkefinansimit me Fondacionin Shqiptaro- Amerikan per Zhvillim (AADF).
- **Permiresimin e struktures se shpenzimeve kapitale** ndaj totalit te shpenzimeve . Ne buxhetin e vitit 2014 investimet nga te ardhurat zene rreth **17%** te totalit te shpenzimeve.
- **Zbatimi i procedurave te prokurimit elektronik edhe per blerjet e vogla**, ne mbeshtetje te Udhzimit nr. 7 date 20.12.2012 “Per zhvillimin e prokurimeve me vlere te vogel ne sistemin elektronik per autoritet kontraktore dhe operatoret ekonomik” si dhe VKM nr. 47 date 23.01.2013 “Per nje shtese ne VKM nr.45 date 21.01.2009 “Per kryerjen e procedurave te prokurimit publik ne menyre elektronike” ,te ndyshuar. Kjo menyre eshte menyra **me transparente e prokurimit**.
- Ligji nr.48/2014 “Per pagesat e vonuara ne detyrimet kontraktore” ,(i cili kushtezon kryerjen e pagesave brenda 30 diteve), pjese e strategjise se Ministrise se Financave per **parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve te prapambetura**, ka dhene efektin pozitiv ne parandalimin e rikrijimit te debive.



BASHKIA BERAT

- Ne vitin 2014 do të kemi shlyerjen e kështj të pare të kredise CEB per ndertimin e banesave sociale me qera, e cila nuk do të prek buxhetin e bashkise, por do të shlyhet nga të ardhurat e qerave të ngurtesuara në llogari të posaçme sipas dispozitave në fuqi.
- Bashkia Berat mbyll vitin buxhetor 2014 *pa detyrime dhe borxhe të mbartuara*, qe do të thote nje permbyse e **mosballancimit buxhetor** të ndodhur në vitet e fundit.
 Viti 2011 u mbyll në deficitin buxhetor prej 51.9 milion leke.
 Viti 2012 u mbyll në deficitin buxhetor prej 49.5 milion leke.
 Viti 2013 u mbyll në deficitin buxhetor prej 68.2 milion leke.
 Viti 2014 u mbyll në deficitin buxhetor prej 12,4 milion leke (investim i mbetur nga A.L.U.I.Z.N.I)

Tregues të performances së Bashkisë Berat

te dhenat në mije leke

STRUKTURA FINANCIARE E BUXHETIT TE VITIT 2014

EMERTIMI	Fakti 2012	Fakti 2013	Fakti 2014
Pesha specifike e të ardhurave lokale/ totalit të ardhurave	55%	55 %	55 %
Pesha specifike e Grandit ndaj totalit të ardhurave	45%	45 %	45 %
Numri i bizneseve shprehur në nr. biznesi	1970	1898	1873
Te ardhura lokale për banor shprehur në leke	2528	2950	3698
Te ardhura lokale për një familje shprehur në leke	9923	11336	14793
Shpenzime për banor shprehur në leke	4961	4909	5410
Shpenzime për familje shprehur në leke	19472	18864	21638
Transferta për banor shprehur në leke	2561	2575	3067
Transferta për familje shprehur në leke	10050	9896	12269
Teprica neto operative për banor shprehur në leke	477	234	1025
Teprica neto operative për familje shprehur në leke	1874	900	4102

Te dhenat në 000 leke


Nr.	Emertimi	Plan Buxheti	Buxheti I Korrigjuar	Fakti	Pesha spec. ndaj tot. në %	Realizimi në %
1	Transferta e pakushtezuar	196,296	196,296	196,296	45	100
2	Te ardhurat lokale	223,018	223,018	200,000	46	90
3	Te ardhurat nga legalizimet	6,000	6,000	-	-	0
4	Te ardhura të trashëguara	36,691	36,691	36,691	8	100
I	Totali I të ardhurave	462,005	462,005	432,987	100	94
1	Shpenzime personeli	170,443	168,039	152,855	37	91
2	Shpenzime Operative	213,273	211,426	193,363	47	91
A	Shuma e shpenz. Korrente	383,716	379,465	346,218	84	91
B	Investime (INO)	78,289	82,540	65,630	16	80
II	Totali I Shpenzimeve	462,005	462,005	411,848	100	89




Grafiku nr. 2

Struktura financiare e buxhetit te vitit 2014

Te ardhurat



Shpenzimet



Nga te dhenat e pasqyres se mesiperme rezultojne keta tregues (duke analizuar kolonen fakt) :

- ✚ Transferta e pakushtezuar ne total perben 45 % te totalit te te ardhurave gjithesej, i njejti raport si ne vitin 2013, kundrejt 46% ne vitin 2012.
- ✚ Te ardhurat lokale perbejne 46% te totalit te te ardhurave gjithesej kundrejt 51% te totalit te te ardhurave ne vitin 2013, dhe 46% ne vitin 2012.
- ✚ Te ardhurat e trashguesehme 8% te totalit te te ardhurave gjithesej , kundrejt 4%te totalit te te ardhurave ne vitin 2013, dhe 8% ne vitin 2012.
- ✚ Shpenzimet e personelit perbejne 37 % te totalit te, kundrejt raporteve ne vitin 2013, 44% ne vitin 2012.
- ✚ Shpenzimet operative perbejne 47 % te totalit te shpenzimeve shpenzimeve gjithesej, e barabarte me nivelin e vitit 2013.
- ✚ Shpenzimet per investime nga te ardhurat perbejne 16% te totalit te shpenzimeve shpenzimeve gjithesej kundrejt 4.5 % ne vitin 2013.



PLANI FINANCIAR I BASHKISE BERAT

Buxheti i Bashkise Berat u miratua me Vendimin e Keshillit te Bashkise nr. 8 date 07.02.2014 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2014”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresen nr. 427/1 date 21.02.2014. Ne mbeshetje te ligjit nr.185 /2013 date 28.12.2014 “Per buxhetin e vitit 2014”, Udhezimit te Ministrit te Financave nr. 2 date 06.02.2012 “Per procedurat standarte te zbatimit te Buxhetit”, Bashkia Berat filloj vitin buxhetor me keta treguesue miratuar :

ne 000 / leke.

A - Te ardhurat gjithsej (I +II).....462005

I - Te ardhurat e buxhetit te pavarur.....265709

- Te ardhura te trasheguara nga viti 2013.....36691

- Te ardhurat Lokale (Plan i vitit 2013).....223018

- Te ardhurat nga Legalizimet6 000

- II - Transferta gjithsej.....196296

- Transferta e pa kushtezuar.....196296

B - Shpenzimet gjithsej383716

C - Investime gjithsej (Teprica neto operative)78289

- Nga te ardhurat e Bashkise71834

- Nga legalizimet6.455

Gjate procedures se zbatimit te buxhetit, pas ndyshimeve te bera dhe transakcioneve financiare te ndodhura ne vitim 2014, dhe te vendimuar ne keshillin bashkiak ne fund te vitit 2014 rezulton kjo situat e financiare:

1. Transferta e pakushtezuar..... 196 296

2. Te ardhurat e vitit (pjesa qe i takon institucionit)..... 200 002

4. Trasheguar nga vitit 2013 ne vitin 2014..... 36 691

TOTALI I TE ARDHURAVE.....432 989

Sipas natyres se shpenzimit, perdorimi i fondeve gjate vitit 2014, ne menyre te permbledhur paraqitete si me poshte:

1. Shpenzime per pagat131 112

2. Shpenzime per sig.shoqerore dhe shendetesore..... 21 743

. Shpenzime operative.....193 363

4. Investime (nga te ardhurat lokale, ALUIZNI)..... 65 630

TOTALI I SHPENZIMEVE..411 848





BASHKIA BERAT

Viti buxhetor 2014 i planifikuar i **ballancuar**, megjithë mbartjen e deticitit të trashëguar nga viti 2013 në shumen prej **68.2** milion leke, pergjithesisht paraqitet me tregues pozitiv. **Trashëguam** nga viti 2013 të ardhura në shumen totale prej **36.6 milion** leke për rredhë borxhi faktik **është 31.6** milion leke.

Buxheti i vitit 2014 likujdoj gjithë detyrimet dhe debite të mbartura për shpenzime operative, detyrime ndaj të tregëve, ndaj përmbarimit për shpenzime gjyqësore, ndaj sipërmarrjes së shërbimit të pastrimit të qytetit, mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të deshmorëve si dhe gjithë detyrimet që mbarten nësite shpënzues: Ndermarrja e Gjellberimit dhe Ndermarrja Rruge Trotuareve dhe Ndicimit Public, Qendra Ekonomike e Arsimit, Qendra Kulturore, dhe Qendra “Lira”.

Duke qenë se materiali është punuar gjatë muajit dhjetor, në bazë të pritshmerisë së realizimit të treguesve, të ardhura që do të trashëgohet nga viti 2014, do të raketohet me degen e thesarit në fillim të muajit janar 2015 dhe do të shpërndahet si pjesë e tepërës neto operative për investime.

Transferta e pakushtëzuar dhe dinamika e saj

Transferta e pakushtëzuar për vitin 2014 në zbatim të ligjit 185/2013 datë 02.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014” akordohet në shumen **196 298 000** lek, ose 36 009 000 leke, 22% më e lartë se në vitin 2013, në ndryshim nga viti 2013 kur kemi këtë situatë:

Transferta e pakushtëzuar për vitin 2013 në zbatim të ligjit 119/2012 datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013” është në shumen 160 289 067 leke, ose 10% më e vogël në indeks dhe 17 710 933 leke më pak në vlerë absolute se njëoftimi i marrë me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 18030 Prot. datë 25.11.2012 “Dërgohet për njëoftim transferta e pakushtëzuar për vitin 2013” në zbatim të VKM nr.802 datë 19.11.2011 “Për propozimin e projekt buxhetit të vitit 2013”. Transferta e pakushtëzuar për vitin 2013 është 4% më e ulët se transferta e korrigjuar e në mes të vitit buxhetor (165 409 000 leke), ose 7% më e vogël se transferta e fillimit të vitit 2012 (171 611 000 leke, miratuar me VKB nr. 3 datë 01.02.2012).

Pasqyra nr. 1

Dinamika e transfertes së pakushtëzuar në vite

në /000 lekë


Vitet	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Transferta	134.617	135.678	160.58	159.898	165.45	165.409	162 289	196 298

Sipas anekseve të perkatese të ligjit të buxhetit, edhe në vitin 2014 vazhdon të mbulohet financiarisht Qendra “Lira” dhe funksioni i konvikteve.

Më qartë ecuria në vite të transfertës shihet në grafikun e mëposhtëm.



Grafiku nr. 3



ANALIZA E REALIZIMIT TE PLANIT TE TE ARDHURAVE

I. Analiza e ecurisë së numrit të subjekteve

Numri i subjekteve aktivë të regjistruar për vitin 2014 pranë Drejtorisë së Taksave Regjistrimit të Biznesit dhe Tregjeve arrin në 1,873 subjekte.

Tabela e mëposhtme paraqet një informacion mbi strukturën e subjekteve aktivë

Lloji i biznesit	Nr. subjekteve aktivë	Struktura në %
Biznes i vogël	1,459	78
Biznes i madh	255	14
Transport	121	6
Institucione shtetërore	38	2
TOTALI	1,873	100

Nga të dhënat rezulton se vazhdon që të ruhet struktura klasike, ku mbizotëron biznesi i vogël, i cili shihet si burim vetpunësimi dhe rrjedhimisht burim gjenerimi i të adhurave nga shumë famije të qytetit tonë.

Pasqyra nr. 2

Numri i subjekteve aktivë për vitin 2015

Nr.	Emertimi	Nr. Subjekteve		
		Meshkuj	Femra	TOTALI
I	Biznes i vogel	940	519	1,459
1	Ushqimore	90	51	141
2	Shitje me pakicë	224	148	372
3	Bar - restorant	124	58	182
4	Prodhim biznes i vogël	53	30	83
5	Shërbime	142	58	200
6	Profesione të lira	70	39	109



BASHKIA BERAT

7	Ambulant	237	135	372
II	Transport	121	-	121
III	Biznes i madh	223	32	255
•	Ndertim	20	-	20
•	Prodhim	32	-	32
•	Import – eksport	171	32	203
III	Institucione	32	6	38
TOTALI		1,316	557	1,873

Për vitin 2014 ne planifikuam që të arrinim në 1,898 subjekte biznesi.

Pra aktualisht vihet re se në krahasim me planin vjetor të vitit 2014 kemi një ulje të numrit të subjekteve të regjistruar me rreth - 25 subjekte. Ulja e numrit të bizneseve ka ardhur kryesisht nga rritja e numrit të subjekteve të biznesit të vogël të cilët pezullojnë aktivitetin ose aplikojnë për cregjistrim pranë sporteleve të QKR-së.


Nga një analizë më e thellë e të dhënave të pasqyrës së mësipërme shohim se :

- Tregtia përfshirë njësite ushqimore, shitje me pakicë dhe/ose shumicë, bar-restorante, import - eksport përbën rreth 67 % të numrit total të bizneseve që operojnë në qytet.
- Shërbimet përbëjnë rreth 16 % të numrit total të bizneseve, sektor i cili është i përqëndruar kryesisht në rajonin e qendrës së qytetit.
- Industria përfshirë prodhimin, ndërtimin përbën rreth 8 % të numrit total të bizneseve, sektor i cili është i përqëndruar në zonat periferike të qytetit.
- Transporti përfshirë transportin e udhëtarëve dhe transportin e mallrave përbën rreth 7 % të numrit total të bizneseve.
- Në tërësi femrat janë në minorancë kundrejt meshkujve në aspektin e drejtimit të një biznesi apo institucioni shtetëror, ndërkohë që drejtimi i bizneseve të mëdha është i dominuar fortë nga meshkujt. Ndërsa sektorë të tillë si transporti, ndërtimi dhe prodhimi janë tregues të stereotipeve gjinore duke u konsideruar si “punë për burra”, sektorë të cilët absolutisht dominohen nga meshkujt.

Në mënyrë grafike të dhënat e pasqyrës së mësipërme paraqiten në grafikun e mëposhtëm :

Grafiku nr. 4

Sektorët kryesorë që operojnë sipas llojit të aktivitetit





Gjithashtu vihet re edhe numri i lartë i subjekteve të cilët mbyllin aktivitetin apo pezullojnë përkohësisht atë.

Më konkretisht për vitin 2014 :

- Janë regjistruar 200 subjekte të rinj biznesi.
- Kanë aplikuar për cregjistrim 130 subjekte
- Janë cregjistruar 95 subjekte
- Kanë pezulluar përkohësisht aktivitetin 142 subjekte
- Kanë riaktivizuar aktivitetin 70 subjekte

Sic shihet ritmi i celjes së subjekteve të rinj sfumohet nga numri i lartë i subjekteve të mbylluar apo që e kanë pezulluar aktivitetin gjatë vitit 2014.

Drejtoria e taksave Regjistrimit të Biznesit dhe Tregjeve ka punuar në drejtim të rritjes së numrit të subjekteve të regjistruar në organet tatimore, por nevojitet një punë dhe më e fortë në drejtim të kontrollit në terren në drejtim të zgjerimit të bazës së tatimpaguesve, gjë e cila do të reflektohet në më shumë të ardhura në buxhetin e bashkisë si dhe në uljen e informalitetit.

Pasqyra nr. 3

Pasqyra e ecurisë në vite të numrit të bizneseve


Vitet	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Nr. subjekteve	1,186	1,329	1,553	1,632	1,772	1,931	1,860	1,970	1,898	1,873
Indeksi në %	100	112	117	105	109	109	96	106	96	99

Karakteristikë e të dhënave të pasqyrës së mësipërme është fakti se përgjithësisht vazhdon që të ruhet trendi rritës nga njëri vit në tjetrin i numrit të subjekteve të biznesit.

Më qartë ky fakt shihet në grafikonin e mëposhtëm.

Grafiku nr. 5

Ecuria në vite e numrit të bizneseve



**II. Analiza e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore**

- Në total, për vitin 2014, të ardhurat priten të realizohen në shumën 200,002,000 lekë kundrejt planit vjetor prej 229,018,000 lekë ose 87.3%.
- Në total kundrejt realizimit faktik të vitit 2013 prej 186,426,000 lekë të ardhurat e vitit 2014 priten të realizohen me +13,576,000 lekë ose +7.28% më shumë se realizimi i vitit të kaluar.

Tabela e mëposhtme paraqet një informacion mbi realizimin e të ardhurave totale nga taksat dhe tarifat vendore sipas viteve.

Vitet	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Të ardhurat totale	165,557	148,860	143,276	159,710	225,715	181,877	186,240	167,986	186,426	200,002

në /000 lekë

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme shohim se viti 2013 përbën vitin më të mirë të realizimit të të ardhurave në këto 4 vitet e fundit.


Grafiku nr. 6**Ecuria në vite e të ardhurave totale**


Tabela e mëposhtme paraqet një informacion mbi realizimin e të ardhurave të pritshme të vitit 2014 sipas grupeve kryesore.

Emërtimi	Të ardhurat në /000 lekë	Realizimi (në %)
Të ardhura nga taksa vendore mbi biznesin e vogël	34,577	89.05
Të ardhura nga taksat vendore	73,582	76.87
Të ardhura nga tarifat vendore	69,194	111.15
Të ardhura nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit	10,505	103.40
Të ardhura të tjera	12,096	75.33
Të ardhura nga legalizimet	48	0.80
TOTALI	200,002	87.33



Grafiku nr. 7

Realizimi i të ardhurave të pritshme të vitit 2014 sipas grupeve kryesore



Nga të dhënat rezulton se peshën kryesore në të ardhurat e realizuara e zënë të ardhurat nga taksat vendore, kryesisht të ardhurat nga taksa vendore mbi biznesin e vogël+tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, taksa mbi ndërtesat, taksa e mjeteve të përdorura dhe të ardhurat nga zënia e hapsirave publike. Gjithashtu për këtë vit vihet re rritja e ndjeshme e të ardhurave nga tarifat vendore.

Nga të dhënat e tabelës dhe nga grafiku i mësipërm vërehet se përgjithësisht të ardhurat janë realizuar në nivel të kënaqshëm.

Në mënyrë më të detajuar të ardhurat sipas grupeve kryesore dhe nën grupeve paraqiten në pasqyrën e mëposhtme.

Pasqyra nr. 4

Të ardhurat e pritshme nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2014

në /000 lekë

Nr	Emertimi/Muaji	12 Mujori		
		Plani	I pritshmi	%
I	Taksa vendore mbi biznesin e vogël	7,000	7,221	103
I/1	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	31,829	27,356	86
TOTALI (I+I/1)		38,829	34,577	89
II	Taksat vendore	95,718	73,582	77
1	Takse table	2,939	2,208	75
•	Tabelë për qëllime identifikimi	194	212	109
•	Tabelë për qëllime reklamimi	2,745	1,996	73
2	Ter ardhura nga zënia e hapsirave publike	17,798	13,811	78
3	Takse ndikimi në infrastrukture nga ndërtimet e reja	20,000	1,241	6
4	Takse fjetje në hotel	1,494	2,048	137
5	Takse mbi token bujqesore	1,023	731	71

**BASHKIA BERAT**

6	Takse e mjeteve te perdorura	9,600	11,382	119
7	Takse e kalimit te se drejtes se pronesisë pronësisë	2,263	2,701	119
8	Takse mbi ndertesat	40,601	39,460	97
•	Biznes	34,998	35,245	101
•	Familje	5,603	4,215	75
III	Tarifat vendore	62,253	69,194	111
1	Tarife e pastrimit	45,263	49,119	109
•	Biznes	32,336	32,271	100
•	Familje	12,927	16,848	130
2	Tarife e ndriçimit publik	8,367	10,541	126
•	Biznes	2,401	2,836	118
•	Familje	5,966	7,705	129
3	Tarife gjelberimi publik	4,249	5,131	121
•	Biznes	1,266	1,295	102
•	Familje	2,983	3,836	129
4	Tarife regjistrim veprimtarie biznesi	1,665	2,959	178
5	Tarifa urbanistike	900	247	27
6	Tarifa te sherbimit administrativ	622	671	108
7	Tarife per license/certifikate ne fushen e transportit rrugor	912	526	58
8	Tarifa per zenien e sallave dhe celje kartele lexuesi	275	-	-
IV	Tarifa te Drejtorise Ekonomike te Arsimit	10,160	10,505	103
1	Te ardhura nga konviktet	960	1,221	127
2	Te ardhura nga cerdhet	3,500	3,461	99
3	Te ardhura nga kopshtet	5,700	5,823	102
V	Te ardhura te tjera	16,058	12,096	75
1	Te ardhura nga parkimi	3,858	61	2
2	Te ardhura nga qerate	7,000	6,289	90
3	Te ardhura nga gjobat, k. vonesa etj..	2,000	5,221	261
4	Te tjera te ardhura nga pronesia	2,500	216	9
5	Te ardhura nga biletat	200	-	-
6	Te tjera debitore dhe gjyqe	500	309	62
VI	Te ardhura nga legalizimet	6,000	48	1
TOTALI		229,018	200,002	87

Nga të dhënat e pasqyrës së mësipërme shohim se realizimi i pritshëm i planit vjetor të të ardhurave të vitit 2014 pritet të realizohet në masën 87 %, me një mosrealizim në shumën 29,016,000 lekë (se bashku me te ardhurat nga legalizimet). Pa te ardhurat nga legalizimet plani vjetor pritet të realizohet ne masen 90 %.

Peshën më të madhe në këtë mosrealizim kryesisht e kanë 3 zëra të të ardhurave të cilët në total kanë një efekt në mosrealizimin e të ardhurave me rreth -29,184,000 lekë ose – 12.7 % të planit të të ardhurave totale të vitit 2014.

- **Mos arkëtimi i të ardhurave të planifikuara nga lejet e ndërtimit** si rezultat i ndryshimeve që i janë bërë ligjit për urbanistikën si dhe bllokimit të dhënies së lejeve të ndërtimit.



BASHKIA BERAT

Aktualisht ne te ardhurat nga ky ze jemi ne te njejtat kushte sikurse gjate fundit te vitit te kaluar, me pothuajse asnje leje ndertimi te dhene gjate kesaj periudhe, si rezultat i pezullimit te dhenies se lejeve te ndertimit per qytetin e Beratit, ne zbatim te vendimit te Këshillit Kombëtar të Territorit të datës 08.10.2013 gje qe u reflektua ne mosrealizimin e te ardhurave nga ky burim shume i rendesishem per financat vendore.

Efekti në të ardhurat e Bashkisë është rreth - 18,759,000 lekë.

- **Mos arkëtimi i të ardhurave të planifikuara nga legalizimet**, të ardhura të cilat mblidhen nga A.L.U.I.Z.N.I. Arkëtimi në nivele të ulëta të ketyre të ardhurave ka 5 vjet radhazi që vazhdon. Arsyeja është e njëjtë, pasi në Bashkinë Berat procesi i Legalizimit ka ecur me hapa shumë të ngadaltë dhe një numër shumë i vogël dosjesh janë përpunuar si dhe kanë përfunduar procesin e legalizimit. Në këtë drejtim, tashmë llogaritjen e detyrimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë për ndërtesat që janë në proces legalizimi do ta kryejë Bashkia Berat dhe kalimin e të ardhurave do ta kryejë A.L.U.I.Z.N.I
Efekti në të ardhurat e Bashkisë është rreth - 5,952,000 lekë

- **Mos arkëtimi i të ardhurave të planifikuara nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël**, të ardhura të cilat mblidhen nga agjenti tatimor Drejtoria Rajonale Tatimore Berat.
Efekti në të ardhurat e Bashkisë është rreth - 4,473,000 lekë.

a. **Të ardhurat nga taksa vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël**

Taksa vendore mbi biznesin e vogël u arkëtua në shumën 7,221,000 leke nga puna e Drejtorisë së Taksave Regjistrimit të Biznesit dhe Tregjeve, për subjektet e biznesit të vogël. Kjo taksë u arkëtua kryesisht gjatë periudhës 1 – 20 Janar 2014 (Kësti i katërt i vitit 2013). Ky ishte kësti i fundit i pagesës, pasi kjo taksë u shfuqizua me tatimin e thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

Ndjekja e këtij tatimi i kaloi Drejtorive Rajonale Tatimore në rolin e agentëve tatimorë, shërbim për të cilin përfitojnë 1% të vlerës së arkëtuar. Për vitin 2014 të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël priten të realizohen në shumën 27,356,000 lekë. Niveli i arkëtimit është në nivelet më të ulta që janë realizuar nga ky burim të ardhurash gjatë periudhës 2005 – 2014.

Në total të ardhurat nga Taksa vendore mbi biznesin e vogël dhe Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

- Për vitin 2014 priten të realizohen në shumën 34,577,000 lekë kundrejt planit vjetor prej 38,829,000 lekë ose 89 %.
- Kundrejt realizimit faktik të vitit 2013 prej 41,649,000 lekë të ardhurat e vitit 2014 priten të realizohen me -7,072,000 lekë ose -17% më pak se realizimi i vitit të kaluar.

Një efekt të konsiderueshëm në mosrealizimin e të ardhurave e jep mosrealizimi i të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël si rrjedhojë edhe e faktit se subjektet kanë paguar në nivelin minimal të përcaktuar pavarësisht nivelit të xhiros së tyre. Në këtë drejtim u ndryshua ligji për sistemin e taksave vendore ku u përcaktua që subjektet me xhiro 2 -8 milion leke/vit të paguajnë jo më pak se 25,000 lekë/vit. Megjithatë nevojitet që agjenti tatimor të ushtrojë kontrole të imtësishme të pasqyrave financiare të paraqitura nga këto kategori biznesesh, gjë e cila duhet të reflektohet në rritje të të ardhurave që duhet ti kalojnë Bashkisë Berat.



BASHKIA BERAT

Pasqyra nr. 5

Ecuria në vite e të ardhurave nga taksa vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

në /000 lekë


Vitet	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Taksa + Tatimi	71,514	52,334	41,667	55,309	53,640	49,740	51,892	45,839	41,649	34,577

Karakteristikë e të dhënave të pasqyrës së mësipërme është fakti se të ardhurat nga ky zë paraqesin kryesisht trend rënës dhe për vitin 2014 priten të jenë në nivelet më të ulta që janë realizuar nga ky burim të ardhurash gjatë periudhës 2005 – 2014.

Më qartë ky fakt shihet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku nr. 8

Ecuria në vite e të ardhurave nga taksa vendore mbi biznesin e vogël



a. Të ardhurat nga taksat vendore

Kryesisht këto të ardhura mblidhen nga Bashkia Berat si dhe nga agjentët tatimorë.

- Të ardhurat nga taksat vendore për vitin 2014 priten të realizohen në shumën 73,582,000 lekë kundrejt planit vjetor prej 95,718,000 lekë ose 77 %.
- Kundrejt realizimit faktik të vitit 2013 prej 63,867,000 lekë të ardhurat e vitit priten të realizohen me +9,715,000 lekë ose +15 % më shumë se realizimi i vitit të kaluar.

Zërat më me peshë në këtë grup të ardhurash janë taksa e ndikimit në infrastrukturë, taksa mbi ndërtesat, të ardhurat nga zënies së hapësirave publike si dhe taksa e mjeteve të përdorura.

Nivel shumë të mirë realizimi paraqesin taksa e tabelës për qëllime identifikimi, taksa mbi ndërtesën që arkëtohet nga biznesi, e cila në pesë vitet e fundit shënon rritje nga njëri vit në tjetrin, taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë, taksa e fjetjes në hotel dhe përgjithësisht të ardhurat nga zënia e hapësirave publike.

Taksa e tabelës për qëllime reklamimi nuk u realizua për efekt të heqjes së tabelave reklamuese nga ndërtimi i pedonales në zonën BID.



BASHKIA BERAT

Për zërat e të ardhurave nga taksa e fjetjes në hotel nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë dhe nga taksat mbi ndërtesat (si për familjet ashtu edhe për biznesin), arkëtimi i vitit 2014 është në nivelin më të lartë që është realizuar gjatë periudhës 2005-2014.

Efektin dominues në mosrealizimin e të ardhurave nga taksat vendore e ka mosrealizimi i të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë (leje ndertimi). Është pikërisht mosrealizimi i të ardhurave të planifikuara nga ky zë, i cili sikurse e theksuam më sipër, si rjedhojë e ndryshimeve që i janë bërë ligjit të urbanistikës dhe bllokimit të dhënies së lejeve të ndërtimit ndikon ndjeshëm në mosrealizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore.

Pasqyra nr. 6

Ecuria në vite e të ardhurave nga taksat vendore

në /000 lekë

Vitet	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Taksat vendore	45,950	49,725	48,529	55,396	85,395	73,565	74,966	65,146	63,867	73,582

Karakteristikë e të dhënave të pasqyrës së mësipërme është fakti se gjatë gjithë periudhës vazhdon trendi rritës i të ardhurave nga taksat vendore. Viti 2009 shënon pikën maksimale të arkëtimeve nga taksat vendore.

Më qartë ecuria në vite e të ardhurave nga taksat vendore shihet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku nr. 9

Ecuria në vite e të ardhurave nga taksat vendore



b. Të ardhurat nga tarifat vendore

Kryesisht këto tarifa mblidhen nga Drejtoria e Taksave Regjistrimit të Biznesit dhe Tregjeve dhe agjenti tatimor sh.a Ujësjellës Kanalizime Berat – Kucovë.

- Të ardhurat nga tarifat vendore për vitin 2014 priten të realizohen në shumën 69,194,000 lekë kundrejt planit vjetor prej 66,638,000 lekë ose 111 %.
- Kundrejt realizimit faktik të vitit 2013 prej 40,857,000 lekë të ardhurat e vitit 2014 janë realizuar me +28,337,000 lekë ose +69 % më shume se realizimi i vitit të kaluar.

Zërat më me peshë në këtë grup të ardhurash janë tarifat vendore të pastrimit, ndricimit, gjelbërimit që mblidhen nga biznesi dhe nga familjet



Të ardhurat nga tarifat vendore paraqesin nivel shumë të mirë realizimi.

Përvec realizimit në nivel shumë të mirë të tarifave mbi biznesin, efekt në realizimin e të ardhurave nga tarifat vendore e ka edhe realizimi i të ardhurave nga tarifat e familjes dhe kjo si rezultat i faturimit të këtyre tarifave së bashku me faturën e ujit të pijshëm. Arkëtimi i vitit 2014 i të ardhurave nga zërat e mësipërm është në nivelin më të lartë që është realizuar gjatë periudhës 2005-2014.

Gjithashtu ndikim ka edhe rritja e këtyre tarifave për subjektet e biznesit të vogël si rezultat i heqjes me ligj të kufizimit të nivelit të vendosjes së këtyre tarifave.

Nivel shumë të mirë realizimi shënoi edhe tarifa e regjistrimit për subjektet e rinj të biznesit që tregon punë të mirë të kryer në drejtim të uljes së informalitetit, por që duhen shfrytëzuar të gjitha potencialet në drejtim të regjistrimit të subjekteve që u shmangen detyrimeve tatimorë.

Realizim shumë të mirë kanë edhe të ardhurat nga tarifat e institucioneve shtetërore.

Theksojmë se Bashkia Berat i ka kushtuar vëmendje maksimale arkëtimin të të ardhurave nga tarifat e familjes.

Nëpërmjet futjes së këtyre tarifave së bashku me faturën e ujit të pijshëm është zgjeruar baza e tatimpaguesve dhe ka sjellë rezultate poitive në buxhetin e bashkisë.

Gjithashtu ndaj cdo qytetari, i cili kërkon që ti ofrohet një shërbim i caktuar administrativ nga bashkia, kërkohet që ai të paraqesë librezën e taksave ku të ketë likujduar taksat dhe tarifat vendore.

Në drejtim të rritjes së të ardhurave nga familjet kemi kërkuar edhe mbështetjen e gjithë drejtorive rajonale për pagesën e detyrimeve të punonjësve të tyre, por që nuk kemi gjetur mbështetje në të gjitha këto struktura.

Pasqyra nr. 7

Ecuria në vite e të ardhurave nga tarifat vendore

në /000 lekë


Vitet	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Tarifat vendore	25,637	29,331	31,387	35,334	52,489	36,369	35,599	35,816	40,857	69,194

Karakteristikë e të dhënave të pasqyrës së mësipërme është fakti se pothuajse gjatë gjithë periudhës vazhdon trendi rritës i të ardhurave nga tarifat vendore. Viti 2014 shënon pikën maksimale të arkëtimeve nga tarifat vendore.

Më qartë ecuria në vite e të ardhurave nga tarifat vendore shihet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku nr. 10

Ecuria në vite e të ardhurave nga tarifat vendore





c. Të ardhurat nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit

Këto tarifa mblidhen nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit

- Të ardhurat nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit për vitin 2014 priten të realizohen në shumën 10,505,000 lekë kundrejt planit vjetor prej 10,160,000 lekë ose 103 %.
- Kundrejt realizimit faktik të vitit 2013 prej 9,239,000 lekë të ardhurat e vitit 2014 priten të realizohen me +1,266,000 lekë ose +14 % më shumë se realizimi i vitit të kaluar.

Pasqyra nr. 8

Ecuria në vite e të ardhurave nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit

në /000 lekë

Vitet	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Të ardhura nga D.E.A	11,432	13,853	15,900	8,704	8,864	10,568	10,908	9,657	9,239	10,505


Karakteristikë e të dhënave të pasqyrës së mësipërme është fakti se në 5 vitet e fundit nuk kemi luhatje të mëdha të arkëtimit të të ardhurave nga ky zë.

Viti 2007 shënon pikën maksimale të arkëtimit nga të ardhurat e Drejtorisë Ekonomike të Arsimit.

Më qartë ecuria në vite e të ardhurave nga kjo Drejtori shihet në grafikun e mëposhtëm

Grafiku nr. 11

Ecuria në vite e të ardhurave nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit



d. Te ardhurat e tjera

Këto të ardhura mblidhen nga Drejtoritë e Bashkisë si dhe nga ndërmarjet e varësisë.

- Të ardhurat e tjera për vitin 2014 priten të realizohen në shumën 12,096,000 lekë kundrejt planit vjetor prej 16,058,000 lekë ose 75 %.



BASHKIA BERAT

- Kundrejt realizimit faktik të vitit 2013 prej 29,244,000 lekë të ardhurat e vitit 2014 priten të realizohen me -17,148,000 lekë ose -59% më pak së realizimi i vitit të kaluar.

Zërat më me peshë në këtë grup të ardhurash janë të ardhurat nga të ardhurat nga qëratë nga ndërtesat dhe pajisjet, të ardhurat nga parkimi, të ardhurat nga gjobat dhe të ardhurat nga privatizimet e ndërtesave.

Nivel shumë të mirë realizimi paraqesin të ardhurat nga gjobat.

Efekt vendimtar në mos realizimin e të ardhurave nga ky zë e kanë kryesisht mos realizimi i të ardhurave nga parkimi ku përfshirja e agjentit tatimor në mbledhjen e të ardhurave nga ky zë nuk dha aspak rezultat pozitiv në të ardhurat e realizuar, prandaj u nërpre kontrata me këte subjekt dhe u ngrit padia në gjykatë ku kërkojmë arkëtimin e të ardhurave të munguara sipas kontratës së lidhur.

Për vitin 2014 shërbimi i parkimit kthehet nën administrimin e Bashkisë Berat.

Pasqyra nr. 9

Ecuria në vite e të ardhurave të tjera

në /000 lekë

Vitet	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Të ardhura të tjera	11,024	3,617	5,793	2,746	3,254	7,611	8,882	9,973	29,244	12,096


Karakteristikë e të dhënave të pasqyrës së mësipërme është fakti se kemi luhatje të arkëtimin të të ardhurave nga ky zë. Luhatjet në këtë zë janë më të mëdha për faktin se shpesh herë gjatë viteve nën zërat e këtij grupi janë konfiguruar si pjesë e grupeve të tjera të të ardhurave. Megjithatë është për tu theksuar fakti se nga viti 2008 dhe në vazhdim vazhdon trendi rrites i të ardhurave të tjera.

Viti 2014 shënon vitin e dytë më të mirë për nga niveli i realizimit për periudhën 2005 – 2014.

Më qartë ecuria në vite e të ardhurave të tjera shihet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku nr. 12

Ecuria në vite e të ardhurave të tjera





BASHKIA BERAT

e. Të ardhurat nga legalizimet

Këto të ardhura mblidhen nga agjenti A.L.U.I.Z.N.I

- Të ardhurat nga legalizimet për vitin 2014 priten të realizohen në shumën 48,000 lekë kundrejt planit vjetor prej 6,000,000 lekë ose 1 %.
- Kundrejt realizimit faktik të vitit 2013 prej 1,569,000 lekë të ardhurat e vitit 2014 priten të realizohen me - 1,521,000 leke ose -97 % më pak se realizimi i vitit të kaluar.

Pasqyra nr. 10

Ecuria në vite e të ardhurave nga legalizimet

në /000 lekë


Vitet	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Te ardhurat nga legalizimet	-	-	-	2,221	22,073	4,024	3,998	1,555	1,569	48

Viti 2014 shënon pikën minimale të arkëtimeve nga të ardhurat nga legalizimet. Karakteristikë është fakti se vit pas viti të ardhurat nga ky zë po shënojnë rënie.

Më qartë ecuria në vite e të ardhurave të tjera shihet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku nr. 13

Ecuria në vite e të ardhurave nga legalizimet



**ANALIZA E REALIZIMIT TE SHPENZIMEVE KORRENTE**

Shpenzimet ne total ne vitin 2014 jane realizuar ne masen 89 % ose ne vlere absolute ne shumen 411 848 000 leke, kundrejt 462 005 000 leke te planifikuara , ne raport me vitin 2013 ku realizimi ishte prej 86 %, ne vlere absolute ne shumen 309 363 000 leke. **Shpenzimet korrente** (Paga, sigurime dhe shpenzime operative dhe te mirembajtjes) jane realizuar ne masen 91.2%, kundrejt 86 % realizuar ne vitin 2013.

Pare ne menyre analitike, realizimi i planit te shpenzimeve eshte ne funksion te plotesimit te funksioneve te veta, te perbashketa dhe te deleguara te percaktuar qarte ne Ligjin nr.8652 date 30.07.2000 “Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

Ajo qe konstatohet qe ne fillim eshte fakti se **indeksi i realizimit te shpenzimeve operative (602)** eshte i **barabarte me indeksin e realizimit te te ardhurave**, (pa legalizimit realializimi I te ardhurave eshte 90%, referuar kapitullit te analizes se te ardhurave), gje qe shpreh se gjate vitit bashkia ka realizuar shpenzime te financuar nga te ardhurat **duke u munduar te ruaj ballancimin buxhetor**.

Pasqyra nr. 11**Pasqyra permbledhese e realizimit te shpenzimeve korrente sipas ndarjes ekonomike**

në 000/lekë

Llogaria ekonomike	Plani 2014	Fakti 2014	% e realizimit
600 (paga)	144 374	131 112	91
601 (Sigurime shoqerore)	23 466	21 743	92
602 (shpenz.operative)	211 525	193 363	91
Totali	379 465	346 218	91.2

Analiza sipas grupeve te shpenzimeve rezulton si me poshte :

- Zeri shpenzime personeli. Pagat e personelit** u realizua ne Shumen 131 112000 leke kundrejt 144 374 000 leke te planifikuara, realizimi ne 91%.

Pasqyra nr. 12**Pasqyra e realizimit te zerit paga ne vite**

në 000/lekë

Funksioni	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Administrata e Bashkise	50,345	55,458	60,912	63,326	56,255	56,838	59,117
Arsimi	8,742	18,260	23,064	20,421	23,623	24,884	23,566
Administrata e DEA	-	-	-	-	5,498	6,414	6,677
Konviktet	-	9,200	12,892	10,321	7,515	7,867	5,535
Cerdhet	8,742	9,060	10,172	10,100	10,610	10,603	11,354
Kultura dhe sporti	14,403	17,419	18,471	17,505	14,336	13,540	11 063
Shumsporetet	1,681	1,914	1,987	2,460	1,060	770	770
Futbolli	1,403	2,035	2,204	-	-	-	-
Qendra Kulturore	6,773	7,730	8,709	9,166	6,860	12,770	10,293




BASHKIA BERAT

Galeria e Arteve	1,133	1,685	1,762	1,921	1,661	-	-
Biblioteka "V.Buharaja"	3,413	4,055	3,809	3,958	4,755	-	-
Sherbime publike	25,850	28,437	29,552	29,171	28,112	28,899	28 671
Gjelberimi	15,248	16,781	16,640	16,781	16,282	16,666	16,351
Rruge Trotuaret	10,602	11,656	12,912	12,390	11,830	12,233	12,320
Qendra Lira	-	-	8,559	9,501	8,753	9,225	8,695
Totali	99,340	119,574	140,558	139,924	131,079	133,386	131,112

Grafiku nr.

Dinamika e shpenzimeve per paga



Pasqyra nr. 13

Realizimi i zerit sigurime shoqerore dhe shendetesore ne vite

në 000/lekë

Funksioni	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Administrata e Bashkise	10,217	10,235	9,823	10,270	9,186	9,443	9,856
Arsimi	1,738	3,344	3,585	3,293	3,810	4,126	3,906
Administrata e DEA	-	-	-	-	897	1075	1,167
Konviktet		1,702	1,983	1,684	1,226	1,322	969
Cerdhet	1,738	1,642	1,602	1,609	1,687	1,729	1,771
Kultura dhe sporti	3,015	3,112	2,988	2,845	2,343	2,248	1,848
Shumsporetet	351	341	321	400	175	130	181
Futbolli	290	357	355	-	-	-	-
Qendra Kulturore	1,414	1,391	1,419	1,485	1,120	2,118	1,476
Galeria e Arteve	231	301	280	306	273	-	-
Biblioteka "V.Buharaja"	729	722	613	654	775	-	-
Sherbime publike	5,194	4,941	4,421	4,805	4,535	4,807	4,781




BASHKIA BERAT

Gjelberimi	3,064	2,920	2,451	2,707	2,648	2,783	2,731
Kruga Trotuaret	2,130	2,021	1,970	2,098	1,887	2,024	2,050
Qendra Lira	-	-	1,386	1,493	1,484	1,541	1,352
Totali	20,164	21,632	22,203	22,706	21,358	22,165	21,743

Grafiku nr. 15

Dinamik e shpenzimeve per sigurime shoqerore dhe shendetesore ne vite



Viti 2012 shenon ulje te fondit te pagave ne vlere absolute Shumen pre 8845 000 leke, sigurime shoqerore 1348 000 leke, ulja ne indeks eshte 7 % ne krahasim me vitin 2011, kjo per faktin se ne vitin 2012 kemi reduktim te nr. te punonjesvee (52 punonjes te shkurtuar ne administraten e bashkise dhe sektoret mbeshtetes te saj,per shkak te gjithe problematikes financiare te trajtuar.)

Ne vitin 2014 ashtu sikurse ne vitet 2009, 2010,2011, 2012,2013, **fondi i vecante** sipas kufizimit ligjor te vendosur nga Qeveria nuk eshte perdorur per te shperbyer punonjesit per rezultate ne pune, ndihma te menjehershme ne rast fatkeqesie,shperblim per dalje ne pension te punonjesve, veprimtari social kulturore etj.

Zerit sigurime shoqerore dhe shendetesore u realizua ne masen 92% ne vlere absolute **21,743 000** leke, duke derdhur rregullisht kontributete e sigurimeve shoqerore e shendetesore.

2. Zeri shpenzime operative u realizua ne masen 91.2% .


**BASHKIA BERAT****Pasqyra nr. 14****Realizimi i zerit shpenzime operative ne vite**

në 000/lekë

Funksioni	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Administrata e Bashkise	11,162	13,797	11,705	10,617	12,033	11,432	15,188
Keshilli Bashkiak	4,561	4,801	4,830	4,830	4,830	4,862	4,842
Keshilli i Rr. Territorit	565	1,110	377	347	-	-	-
Keshilli Teknik	169	-	117	120	-	-	-
Shp. Per bot., prom, e publik.	52	103	-	420	-	-	-
Administrata e pergjithshme	16,509	19,811	17,029	16,334	16,863	16,294	20,000
Arsimi	20,710	20,536	22,892	17,485	20,194	23,062	28,330
Arsimi I mesem dhe baze	16,134	10,408	11,761	9,872	10,267	14,923	18,332
Konviktet	1,716	6,674	6,800	4,900	5,391	3,294	4,046
Cerdhet	2,860	3,454	4,331	2,713	4,536	4,845	5,952
Kultura dhe sporti	23,567	23,494	21,967	20,511	38,446	21,314	29,400
Shumsportet	4,654	5,151	4,154	2,375	3,272	2,518	4,984
Futbolli	9,102	9,758	8,728	11,477	25,950	12,975	16,500
Qendra Kulturore (Ork+Banda)	7,316	6,308	7,099	4,622	6,383	5,753	7,916
Galeria e Arteve	983	1,034	1,033	787	1,161	-	-
Biblioteka "V.Buharaja"	1,427	1,175	908	1,250	1,590	-	-
Keshilli I kultures	85	68	45	-	90	68	-
Sherbime	85,337	89,242	82,746	64,508	85,081	84,707	111,494
Pastrimi	48,011	51,000	46,802	37,718	44,540	51,170	67,620
Varrezat	2,141	1,887	2,402	2,332	3,128	3,490	4,246
Dekori	1,077	899	1,209	1,259	1,080	1,788	1,568
Transporti Urban	9,396	8,941	3,759	2,287	4,879	4,879	6,000
Gjelberimi	6,100	5,753	4,432	3,358	5,046	4,391	4,487
Rruge Trotuaret	18,612	20,762	24,142	17,554	26,408	18,989	21,305
Kontr. i Keshillit te Qarkut	4,000	4,000	4,000	2,331	1,750	3,000	4,000
Fondi Rezerve	3,327	2,853	1,280	236	1,307	0	0
Emergjencat	788	1,342	1,555	694	500	666	1,000
Familjet ne nevojë	695	389	577	584	507	900	900
Agj. tatimore(transfertaBID,	-	-	1,500	1,230	-	-	368
Qendra Lira	-	1,072	3,172	2,685	3,381	3,869	4,640
Totali	154,933	162,739	156,718	126,598	168,029	153,812	193,363



Grafiku nr. 16
Dinamika e shpenzimeve operative ne vite



Ng ate dhenat e mesiperme konstatohet lehtesisht fakti se grupi i shpenzimeve operative ka pesuar luhatje dhe nuk kan trend rrites nga njeri vit ne tjetrin.

Ne vitin 2011 kemi 30 120 000 leke me pak shpenzime operative se ne vitin 2010, por duhet te theksojme faktin se viti 2011 u mbyll me dificin buxhetor prej 51 239 000 leke nga te cilat 43 768 000 leke e perbenin shpenzimet operative te kryera e te palikujduara. **Dificiti buxhetor krijoi paaftesi paguese.**

Viti 2012 ka nje nivel te realizimit te shpenzimeve prej 168 029 000 leke ose 41 431 000 leke me shume se fakti i vitit 2011, qe do te thote **se mbartja e dificitit rriti artificialisht nivelin e shpenzimeve.**

Ne vitin 2013, ndodh po e njejta situatë, **mbartja e borxhit te trashëguar nga viti 2012 ne shumen 49 557 300 leke, rriti planin e shpenzimeve te vitit buxhetor 2013.**

Ne vitin 2014 shpenzimet operative ne total prej **193,363 000 leke, kane nje rritje prej 27% ne krahasim me vitin 2013, rritje artificial per shkak te likuidimit te borxheve te mbartura.**

Sipas ndarjes ekonomike analiza eidenton :

- **Perdorim eficient te fondeve** ne dispozicion ne perputhje me strukturen buxhetore te miratuar.
- **Zbatim korrekt te akteve ligjore e nenligjore** qe rregullojne perdorimin e tyre.
- **Pergjegjshmeri administrative dhe financiare** deri tek administrator me i drejteperdrejte per cdo shpenzim te kryer.
- **Ekonomizim, limitim te perdorimit te fondeve nga njesite shpenzuese** duke mos cenuar nivelin dhe cilesine e kryerjes se sherbimit.
- **Auditim dhe kontroll** te Njesite Shpenzuese dhe drejtorive per zbatimin e ligjishmerise nga njesia e auditit te brendshem dhe KLSH.

**ANALIZA E SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE:****I. Programi i administrates se bashkise (planifikim, menaxhim, administrim)**

Pershkrimi i Programit. Realizon manaxhimin financiar te Bashkise Berat dhe perfshin shpenzimet e nevojshme administrative per mbarvajtjen e punes ne permbushjen e funksioneve te percaktuara ne legjislacion.

Politika e Programit. Politika e ketij programi konsiston ne permiresimin e funksionimit dhe menaxhimit te Bashkise Berat, zhvillimit te kapaciteteve menaxhuese dhe ne garantimin e permiresimit te vazhdueshem te burimeve njerzore dhe perdorimit me efektivitet te burimeve financiare te Bashkise.

Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", neni 8 pika 1/c, neni 32 pika ç, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. datë "Mbi miratimin e strukturës organike, te numrit te punonjesve pagat e administrates, ndermarjeve dhe njesive shpenzuese ne varesi te Bashkise Berat per vitin 2014" u miratua struktura e Bashkise Beratit dhe e njesive Shpenzuese ne varesi te saj.

Programi i administrates se bashkise, eshte realizuar me 94 punonjes te miratuar **me objektiv:** zhvillimin e kapaciteteve menaxhuese, garantimin e permiresimit te vazhdueshem te burimeve njerezore dhe perdorimin me efektivitate te burimeve financiare te bashkise, te ofroje nje partneritet, kordimin dhe mirekuptim midis paleve duke garantuar mbarevajtje optimale te punes ne sherbim te komunitetit.

Pasqyra nr. 15**Realizimi i shpenzimeve**

në 000/lekë

Emertimi i shpenzimit	Plani 2014	Fakti 2014	Realizimi ne %
Paga	66253	59117	89
Sigurime shoqerore	10864	9856	91
Shpen. operative	21741	20000	92
Totali I shpenzimeve korrente	98858	88973	90
Investime	2450	1121	46
Totali i shpenzimeve	101308	90094	90

Zeri; paga eshte realizuar ne masen 89 % ose mosrealizimi ne vlere absolute prej 7136000 leke, per arsye se : Vendet te punes vakand per shkak te procedurave te rekrutimit te punonjesve ne baze te ligjit "Per statusin e nenpunesit civil", krijuan kursim te fondit te pages. Vendimi I Keshillit te Ministrave nr. 591 date 10.07.2013 "**Per disiplinimin e perdorimit te fondeve buxhetore per vitin 2013**" pezulloj perdorimin e fondit te vecante per shperblimin e punonjesve per rezultate ne pune, shperblimin per raste te tjera si ndihme e menjehereshme ne rast fatkeqesie, te daljes ne pension te punonjesve, si dhe per veprimtari social kulturore.

Zeri; sigurime shoqerore eshte realizuar ne masen 91%, jane derdhur rregullisht kontributet.

Zeri ; shpenzime operative eshte realizuar ne masen 90% kundrejt detyres se planifikuar, **dhe 100%** kundrejt planit te celur, mosrealizmi ne masen 9885 000 leke.



Produktet qe u realizuan

- Plotesimi i kerkesave per kushte normale te punes ne administrate.
- Sigurimi i materialeve dhe sherbimeve speciale.
- Realizimi i sherbimeve ndaj te treteve.
- Realizimi i shpenzimeve te transportit.
- Sigurimi i levizjes se nenpunesve dhe realizimi i shpenzimeve te transportit.
- Mirembajtja e mjeteve te transportit, pajisjeve te zyrave dhe vet ambjenteve te zyrave nepermjet realizimit te shpenzimeve te, mirembajtjes se zakonshme.
- Realizim i i shpenzimeve per pritje percjellje.
- Realizimi i shpenzimeve te tjera operative.

Ne zerin e shpenzimeve veprimtari dhe aktivite Te vitit 2014, Jane likujdua edhe aktivitetet dhe veprimtarite e zhvilluara ne vitin 2013, e te mbartura si detyrime ne vitin 2014.

Te tilla si: Shpenzime te aktivite te festive te 28-29 nentorit, Ceremonia “Njeriu i Vitit 2013” dhe festat e fundvitit.

Veprimtari dhe aktivite te zhvilluara e te mbeshtetura financiarisht ne vitin 2014.

- Projekti “**Urat e Ballkanit flasin**”. Bashkia Berat, Unesco, Fondacioni Ballkanika dhe Raiffeisen Bank bashke financuan ne Mars kete event.
- Veprimtarite me rastin e 7 marsit. (Takimi me mesuesit).
- Aktivite me rastin e 70 vjetorit te clirimit te qytetit te Beratit dhe 70 vjetorit te clirimit te Atdheut.
- Bashkia Berat mori pjese ne Panairin Kombetar Levizes 2014, si dhe ne Panairin Nderkombetar te Turizmit (nentor 2014), organizuar nen kujdesin e vecante te Ministrise se Zhvillimit Urban dhe Turizmit.
- Ceremonia “**Njeriu i Vitit 2014**” e te tjera aktivite qe do te evidentohen ne vijim nga njesite shpenzuese perkaterse.
- **Pritje percjellje delegacione te huaja**, ne shumen 102700 leke, shifer kjo me e ulet krahasimist, me vitete e kaluara, pasi kemi marre ne konsiderate edhe rekomandimet e Klsh-se, per minimizimin e shpenzimeve ne kete ze.

Viti buxhetor 2014 nuk rezulton me detyrime te palikujduara, me perjashtim te aktiviteve qe realizohen ne ditet e fundit te dhjetorit.

II . PROGRAMI I ARSIMIT PARAUNIVERSITARE DHE EDUKIMIT

Përshkrimi i programit. Programi i arsimit parauniversitar dhe edukimit parashikon veprimtarine ekonomike,financiare dhe ate te sherbimit ne mirembajtjen e kopshteve,cerdheve dhe shkollave 9-te vjecare,te mesme te pergjithshme dhe profesionale qe jane brenda teritorrit dhe juridiksionit te Bashkise Berat.

Njësia Shpenzuese; Qendra Ekonomike e Arsimit

Fondi i planifikuar ne kete program: 62 389000 leke, fondi i realizuar: **55902 000 leke,**

**BASHKIA BERAT****Pasqyra nr. 16****Realizimi i shpenzimeve**

në 000/lekë

Emertimi i shpenzimit	Plani 2014	Fakti 2014	Realizimi ne %
Paga	24354	23566	96.7
Sigurime shoqerore	4087	3906	95.6
Shpen. operative	31448	28330	90
Totali I shpenzimeve korrente	59889	55802	93
Investime	2500	100	4
Totali i shpenzimeve	62389	55902	89.6

Objektivat e programit: Permbushjen me sukses e te gjitha detyrimeve ligjore ne fushen e arsimit , synimi i permbushjes se standarteve te miratuara nga M.A.SH ne Strategjine e Arsimit, permiresimin dhe rritjen e efektivitetit ne cilesine e sherbimeve ndaj institucioneve arsimore si dhe ne forcimin e kontrollit te fondeve te planifikuara ne buxhetin e arsimit, mirembajtjen e kopshteve, cerdheve dhe shkollave te qytetit, duke synuar ne permbushjen e standarteve optimal.

Me moton “Te duash femijet eshte nje ndjese, te kujdesesh dhe te manaxhosh institucionet ku ata rriten si cerdhe, kopeshite e konvikte eshte sa funksionale aq dhe njerezore”, Qendra Ekonomike e Arsimit me 63 punonjes gjithesej ka funksionuar si njesi shpenzuese ne varesi te Bashkise per te tretin vit, duke permbushyur objektivat e programit.

Pasqyra nr. 17**Realizimi i shpenzimeve per Cerdhet e qytetit**

në 000/lek

Emertimi i shpenzimit	Plani 2014	Fakti 2014	Realizimi ne %
Paga	11501	11354	98.7
Sigurime shoqerore	1883	1771	94
Shpenzime operative	5495	5495	100

Pasqyra nr. 18**Realizimi i shpenzimeve per Arsimin baze (9-vjecar)**

në 000/lek

Emertimi i shpenzimit	Plani 2014	Fakti 2014	Realizimi ne %
Paga e D.E.A	6732	6677	99
Sigurime shoqerore	1202	1167	97
Shpenzime operative	20275	19201	95

Pasqyra nr.19**Realizimi i shpenzimeve per Konviktet**

në 000/lek

Emertimi i shpenzimit	Plani 2014	Fakti 2014	Realizimi ne %
Paga	6121	5535	90
Sigurime shoqerore	1002	969	97
Shpenzime operative	5678	3634	64



Shpenzimet ne total jane realizuar ne masen **89,6%** , mosrealizimi ne shumen prej,kundrejt **86%**, moserealizimi ne vlere absolute ne masen 8 267 000 leke, **ne vitin 2013.**

- Zeri **paga** dhe **gigurime shoqerore** eshte realizuar ne masen **94 dhe 96%**, **jane** paguar ne kohe pagat e punonjesve e jane duke derdhur rregullisht sigurimet shoqerore dhe shendetesore.
- Realizimi ne masen **93% te shpenzimeve operative**, kundrejt **90%** realizimi ne vitin 2013, realizim ne nivele relativisht te kenaqeshme, tregon **vemendjen maksimale** ndaj ketij **funksioni perbashket** midis Qeverisjes Vendore dhe asaj Qendrore, ndersa kundrejt planit te shpenzimeve te celura rezulton realizimi ne masen **100%**, **gje qe tregon se institucioni ka mireadministruar fondet.**

➤ **Produktet u realizuan:**

1. Materiale zyre e te pergjithshme.Ketu perfshihen te gjitha materialet per pastrim, disifektim, ngrohje e gatim per nevojat e kopshteve, cerdheve, shkollave, konviktit dhe administrates se qendres ekonomike.
2. Materiale dhe sherbime te tjera special: si uniforma dhe veshje speciale, ushqimet e femijeve, ilace mjeksore si dhe te tjera materiale dhe sherbime speciale per nevojat e kopshteve, cerdheve, konvikteve dhe shkollave te qytetit.
3. Sherbime nga te trete .Perfshihen te gjitha shpenzimet per energjine elektrike,ujin e pijshem dhe telefon per te gjitha institucionet e arsimit parashkollor, 9-te vjecar, te mesem te pergjithshem e profesional si dhe te cerdheve.
4. Shpenzime transporti, shpenzimet per transportin e ushqimeve te kopshteve, cerdheve dhe konvikteve te qytetit.
5. Mirembajtje te zakonshme, materialet per mirembajtje te ndryshme, riparime e lyerjen e objekteve arsimore.
6. Shpenzime te tjera operative

Analiza ekonomike e treguesve analitik te shpenzimeve operative evidenton faktin se :

- **40%** te tolalit te shpenzimeve operative ketij institucioni kalon per llogari te pagimit te ushqimit te kopshteve, cerdheve dhe konvikteve,
- **50 %** te tolalit te shpenzimeve operative te ketij institucioni kalon per llogari te sherbimeve ndaj te treteve, energjise elektrike, ujit, telefonit.
- **3%** te tolalit te shpenzimeve operative te ketij institucioni kalon per llogari te shpenzimeve per qera mabjenti.
- **3%** te tolalit te shpenzimeve operative te ketij institucioni kalon per llogari te shpenzimeve per shpenzime administrative.
- **4%** (te tolalit te shpenzimeve operative leke te ketij institucioni kalon per llogari te shpenzimeve per mirembajtje.

Qendren Ekonomike e Arsimit mbylli vitin buxhetor 2014 pa detyrime te palikujduara.

**4. PROGRAMI I SHERBIMEVE PUBLIKE****1. Mirembajtje rruge trotuare dhe ndricim publik**

Njësia Shpenzuese: Ndërmarrja e Rrugë Trotuareve dhe Ndicimi Publik.

Fondi i planifikuar 38 578 000 leke, fondi i realizuar 35 675 000

Pasqyra nr. 20

Realizimi i shpenzimeve

në 000/lekë

Emertimi i shpenzimit	Plani 2014	Fakti 2014	Realizimi ne %
Paga	13 255	12 320	93
Sigurime shoqerore	2 170	2050	94.4
Shpen. operative	23153	21305	92
Totali i shpenzimeve	38 578	35 675	92.4

Pershkrimi i Programit. Programi i Mirëmbajtjes së rruge trotuareve dhe ndicimit publik parashikon mirëmbajtjen e vazhdueshme të rrugëve kryesore, trotuareve, segmenteve rrugore, rehabilitimin e kalldreve, mirembajtjen e sistemit të ndicimit të qytetit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve për komunitetin.

Objektivat e Programit. Te realizojme mirembajtjen e rrugeve ne masen 80-85% te mirembajtura mire dhe shume mire, permiresimin e rrjetit ekzistues te rrugeve te asfaltuara, të shtrirë në të gjithë qytetin, që t'u mundësojë qytetarëve qarkullim normal ecjen e këmbësorëve dhe mjeteve,

Produktet që u realizuan:**1. Mirëmbajtja e Rrugëve dhe Trotuareve**

Jane mirembajtur : Siperfaqe me rruge te asfaltuara 205000 m², siperfaqe qe trajtohen me stabilizant jane 75860 m² siperfaqe te shtruara me kalldrem jane 61000 m², siperfaqe me trotuare jane 65000 m², mure mbajtes 500 m², kapak pusetash 580 cope, ujembledhes 490 cope, si dhe zgara pritese 35 cope. Ky element shpenzimi ze 11 % e buxhetit te shpenzimeve operative te Ndermarrjes.

2. Mirëmbajtje Ndrichimi Rrugor. Mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit rrugor ekzistues ku përfshihen punimet për mirëmbajtje të rrjetit të ndriçimit rrugor në rrugët e qytetit, riparime ditore, si rezultat i dëmtimeve dhe defekteve në linjat përkatëse, qe kap nje siperfaqe e ndicuar prej 1 503 000 m².Rrjeti i ndicimit publik mbulon relativisht qytetin dhe komandohet neprmjet 50 gabinave, inventari i shtyllave elektrike me gjatesi 8 ml eshte 1050 cope. Ndicimi publik, si element shpenzimi ze 80% te buxhetit te shpenzimeve operative te Ndermarrjes.

3. Mirëmbajtje e sinjalistikës rrugore

Përfshihet mirëmbajtje e sinjalistikës rrugore horizontale dhe vertikale në rrugët e qytetit, duke kryer të gjitha proceset e punës për mirëmbajtjen, aplikimin e vizatimeve trafikndarrës dhe të këmbësorëve, për mirëmbajtjen e sinjalistikës vertikale, tabelave rrugore etj.



2. Gjelberimi

Pershkrimi i Programit. Programi “Gjelberimi,” konsiston ne mirëmbajtjen e siperfaqeve te gjelberta duke kryer te gjitha proceset teknologjike te punes per mirembajtjen e siperfaqeve me bar, lulishte, shkurre dekurative, bordure te gjelber, mbjellja e pemeve dekurative etj. Shtim te siperfaqeve te gjelberta, duke synuar mobilimin e gjelber te cdo rruge, sheshi dhe shtimin e parqeve per femijet, si nje dekor edukues e atraktiv per qytetin dhe qytetaret.

Njësia Shpenzuese: Ndermarja e Gjelberimit

Fondi i planifikuar 25 484 000 leke, fondi i realizuar 24 031 000 leke.

Pasqyra nr. 21

Realizimi i shpenzimeve

në 000/lekë

Emertimi i shpenzimit	Plani 2014	Fakti 2014	Realizimi ne %
Paga	17 552	16 351	93
Sigurime shoqerore	2 885	2 731	94.6
Shpen. operative	4 573	4 487	98
Totali i shpenzimeve korrente	25 010	23 569	94.2
Investime	474	462	97.4
Totali i shpenzimeve	25 484	24 031	94.3

Objektivat e Programit; Mirembajtjen e struktures se siperfaqeve te gjelberta duke kryer te gjitha proceset teknologjike te punes per mirembajtjen e siperfaqeve me bar, lulishte, shkurre dekurative, bordure te gjelber.

- ❖ Shtimi i siperfaqeve te gjelberta duke shtuar mbjelljet me lule zezonale, sip, me bar, mbjellja e pemeve dekurative etj.
- ❖ Reabilitimin e sistemit te rrugicave dhe shesheve te pushimit ne lulishten e qendres.
- ❖ Reabilitimi i sistemit te ujitjes ne lulishten e qendres.
- ❖ Reabilitimi i sistemit te ujitjes ne lulishten e rruges hyrese te Beratit.
- ❖ Ndertimi i Tendave dhe i pjergullave.
- ❖ Kompletimi me stola dhe tavolina për të krijuar vende shplodhje për qytetarët.
- ❖ Sistemim i gjelbert i bankinave te lumit “Osum”.

Produktet që u realizuan;

1. Mirëmbajtje e struktures se gjelbert ne qytetin e Beratit:

- Kryerjen e të gjitha proceset teknologjike të punës si në një sipërfaqe prej 79 274 m².siperqafe rruge dhe sheshe 15 331 m², sip. me bar dekorativ 57 486 m², sip. me lule sezonale 3 748 m², drure zbukuruese rrugore 5 600 rrenje, gardh i gjelbert 1 120 ml, tunel i gjelbert 50 ml.
- Mirembajtjen e 14 tendave te gjelberta dhe 10 qoshka dekorative, kangjella dekorative 2 112 ml,



- Mirëmbajtje e gjithë inventarit të pershire ne sipërfaqet e gjelberta si, stola, pllaka me zaje, kosha mbeturinash, ndicuesa, cezma zbukuruese, kende lojrash për femije, e kende arhetuese për moshat e treta, lapidar, buste, skulptura.

3. Pastrimi i qytetit

Përshkrimi i Programit. Programi i shërbimit të Pastrimit parashikon pastrimin, grumbullimin, transportimin e mbetjeve urbane dhe inerte të qytetit nga vendgrumbullimet deri në pikën e vend depozitimit të mbetjeve urbane të qytetit tonë me qëllim përmirësimin e ambientit dhe uljen e ndotjes së tij në qytet

Njësia Shpenzuese; Sipërmarja e pastrimit.

Fondi i planifikuar 67 620 000 leke, fondi i realizuar 67 620 336 leke.

Objektivat e Programit;

- Pastrimin e Rrugëve dhe Shesheve kryesore të qytetit për tu krijuar qytetarëve një ambient të pastër.
- Grumbullimin dhe heqjen e mbetjeve urbane në pikat e vend-qëndrimeve të kontejnerëve dhe pikave statike çdo ditë për të krijuar ambiente sa më të pastra dhe uljen e ndotjes në maksimum në blloqet e banimit (lagjesh, pallatesh, institucione publike).
- Grumbullimin dhe heqjen e mbetjeve inerte në pikat e vendgrumbullimeve dhe pikave statike çdo ditë për të eliminuar ndotjet në blloqet e banimit (lagjesh, pallatesh, institucione publike) si dhe në ruajtjen e infrastrukturës mjedisore në standarde që kërkon koha.
- Larja dhe lagia e rrugëve, në rrugët dhe sheshet kryesore të qytetit për uljen e ndotjes mjedisore nga qarkullimi i makinave dhe punimet ndërtimore.
- Përmirësimi i kushteve teknike në vend depozitimit të mbetjeve urbane për uljen e ndotjes së ambientit të qytetit.
- Përmirësimi i kushteve teknike në dezinfektimin e pikave nevralgjike në qytet që shkaktojnë ndotje të ambientit dhe në institucionet publike (në vendstrehimet, kopshtet, shkollat, spitalet etj..)

Produktet që u realizuan;

1. Pastrimi i Rrugëve

- Pastrimi i rrugëve sipas skemës dhe zgjerimi i kësaj skeme në vitet në vazhdim sipas standardeve bashkëkohore duke rritur cilësinë e shërbimit ndaj komunitetit si dhe uljen e ndotjes në mjedisin rrethues.

2. Mirëmbajtja e Ambienteve Publike

- Uljen e ndotjes në mjediset publike ku përfshihen blloqet e pallateve dhe lagjeve të qytetit të cilat nuk janë të planifikuara në skemën e shërbimit ditor.

3. Grumbullim – transportim i mbetjeve urbane

- Largimi çdo ditë sipas një grafiku të miratuar të mbetjeve urbane nga vendgrumbullimi i kontejnerëve dhe pikave statike.



- Largimi sipas një grafiku të miratuar të mbetjeve inerte nga vendgrumbullimi i mbetjeve urbane dhe ambientet publike.

5. Larje dhe lagje e rrugëve

- Larjen e rrugëve për uljen e ndotjes dhe lagje të rrugëve kryesore gjatë sezonit Maj-Tetor sipas një grafiku të miratuar.

6. Dizinfektimi, Deratizimi dhe Dezinsektimi

- Dizinfektimin, deratizimin, dizinsektimin e ambienteve publike për të pasur nja ambient sa më të shëndetshëm për komunitetin.

7. Mirëmbajtje e mjeteve që kryejnë pastrimin e qytetit

- Për një shërbim çdo ditë të ambienteve ku komuniteti ka në përdorim duhet dhe një gatishmëri sa më efektive e mjeteve që përdoren për largimin e tonelatave mbetje urbane dhe inerteve.

4. Mirembajtja e varrezave publike, varrezave të deshmorëve dhe dekorit të qytetit.

Njësia Shpenzuese; Sipermarja e shërbimit.

Mirembajtja e varrezave publike, varrezave të deshmorëve:

Fondi i planifikuar 4 141 000 leke fondi i realizuar 4 007 165 leke.

Dekori: Fondi i planifikuar 1 849 000 leke fondi i realizuar 1 568 207 leke.

Pershkrimi i Programit Mirëmbajtje e sipërfaqeve dhe parcelave në varrezat publike dhe të deshmorëve, sipas volumeve të përcaktuara në preventivin e kontratës së sipërmarrjes dhe mirëmbajtja e dekorit të qytetit, për festat zyrtare dhe sipas programeve të Bashkisë.

5. Transporti Urban.

Njësia Shpenzuese; Bashkia Berat (subvensioni)

Ndermarrja: Parku i Udhëtareve Berat.

Gjate viti 2014 shërbimi i transportit urban është kryer nga Ndermarrja me status Ndermarrje Shtetërore. Është financuar 100% me nivelin e planifikuar në buxhetin e vitit 2014 në shumën prej 6000 000 leke.

Gjate auditimit nga KLSH u la detyrë që Bashkia Berat të marrë masë për zgjidhjen e problemeve që paraqet Parku Udhëtareve Berat, i cili shoqërohet me humbje të njëpasnjëshme për 3 vite radhazi dhe me një borxh publik me vlerën 7,381,090 leke të krijuar deri në fund të vitit 2013. Në lidhje me këtë pikë është reflektuar. Vendimi nr.34 datë 23.10.2014 i Këshillit Bashkiak ndryshoi formën e kryerjes së shërbimit të transportit urban, duke hapur rrugë konkurrencës së operatoreve privat.

**PROGRAMI I ZHVILLIMIT TE KULTURES, TURIZMIT DHE SPORTIT**

Përshkrimi i programit. Programi i kultures tenton ti jape nje hapësire e dhe me te plote jetes artistike dhe kulturore te qytetit jo vetem duke u mbeshtetur ne rivitalizimin e metejshem te projekteve ekzistuese, te cilat jane kthyer tashme ne nje tradite per qytetin e Beratit, por edhe duke dhene hapësira te reja per projekte te tjera inovative te cilat vijne prane Qendres Kulturore e Bashkise Berat nga persona te trete, shoqeria civile apo ente te tjera kombetare e nderkombetare. Ky program do të tentojë të promovojë vlerat kulturore të qytetit ç`ka do ta bente jo vetem për qytetarin e Beratit, por edhe turistin dhe vizituesin e tij, me atraktiv.

Njësitë shpenzuese: Bashkia Berat

➤ **Qendra Kulturore “Margarita Tutulani”**

Fondi i planifikuar ne kete program 32999000 leke, fondi i realizuar 27121000 leke

Ka funksionuar edhe per vitin 2014 si nje njesi shpenzuese duke pasur ne perberje funksionimin e Qendra Kulturore “Margarita Tutulani”, Bibliotekes “Vexhi Buharaja” dhe galerise se arteve “E.Lear” si dhe Klubin e shumesporteve “Tomorri”, me nje presonel prej 25 punonjesish .

Pasqyra nr.22

Realizimi i shpenzimeve per Qendren Kulturore “Margarita Tutulani”

në 000/lek

Emertimi i shpenzimit	Plani 2014	Fakti 2014	Realizimi ne %
Paga	13011	11063	85
Sigurime shoqerore	1898	1848	97
Shpenzime operative	16650	12900	77
Investime	1440	1310	91
Totali i shpenzimeve	32999	27121	82

Shpenzimet ne total jane realizuar ne masen 82%, moserealizimi ne vlere absolute ne masen 58789 000 leke. Zeri **paga** dhe **sigurime shoqerore** eshte realizuar ne masen 82 e 97 %, duke mos krijuar deficit. Realizimi ne masen 77%,**te shpenzimeve operative**, kundrejt 59% te realizuar ne vitin 2013.



Viti 2014 është karakterizuar nga një punë e kualifikuar dhe produktive e punonjësve të kësaj njesie shpenzuese për të realizuar objektivat dhe detyrimet ligjore si në drejtim të zhvillimit të aktiviteteve kulturore e sportive ashtu dhe mirembajtjen e ambjentëve të gjithë institucioneve të Qendres Kulturore “M.Tutulani”, Galerise “E.Lear”, Bibliotekes “V.Buharaja”, Klubit Shumsportesh “Tomori”.

Zhvillimi i aktiviteteve kulturore artistike dhe sportive janë realizuar e meshtetur me fondet e akorduara institucionit, donatereve, dashamiresve të artit, bashkepunimit me shkollat e qytetit.

Gjithsej janë zhvilluar 82 aktivitete kulturore e sportive të cilat janë të dokumentuara me foto dhe të publikuara në webin e Bashkisë.

- a) Angazhimi ka qenë në drejtim të rritjes së cilësive artistike dhe performancës në të gjitha zhaneret kulturore dhe sportive.
- b) Risi dhe sukses i rreth 70 aktiviteteve të zhvilluara nga Q.Kulturore dhe institucionet në varesi janë, dhe bashkepunimet me shkollat e qytetit të cilat kanë pasur asistencën e profesionistëve të tane, për një rritje profesionale të çdo aktiviteti.
- c) Pasurimi me orkestracione të reja të tre formacioneve muzikore.
- d) Riorganizimi i formacioneve muzikore me elemente të rinj të talentuar dhe spikatja e të rinjve në muzikën moderne
- e) Spikatja e elementëve të rinj nga shkollat në zhanerin e aktrimit për të ngritur një bertham me aktor amator

Nga pikpamja ekonomike –financiare, sektori i financës ka qenë i angazhuar maksimalisht në ndjekjen e procedurave dhe realizimit të treguesve të buxhetit konform legjislacionit.

- a) Është bërë plotësimi i dosjeve me kalendaret mujore të gjithë urdher shpenzimeve të nxjerra gjatë çdo muaji.
- b) Ndjekja e procedurave të tenderimit për blerjet e shpenzimeve operative, investimet e bera dhe listet pagesat në aktivitetet e zhvilluara me gjithë dokumentacionet e nevojshme justifikuese
- c) Janë bërë likuidimet e gjithë borxheve dhe debive të trashëguara nga vitet 2012-2013.
- d) Hartimi për likuidimin e shpenzimeve të kryera me një rregullsi sipas datave kronologjike gjatë vitit pa e kaluar afatin 30 dite.

Është bërë mirembajtja e ambjentëve riparime të pjesëshme dhe lyrja në Qendren Kulturore, Galeri, Bibliotekë. Salla e koncerteve është pajisur me 2 kondicioner dhe pasurimi i fondit të Bibliotekës dhe Galerisë.

Grupi kengës Qytetare është vlerësuar me certificate mirënjohje dhe certifikata për kengetaret Ping-pongu për të 8-tën herë kampion i Republikës.

**BASHKIA BERAT****Aktivitetet e zhvilluara nga Qendra Kulturore “Margarita Tutulani”**

Nr.	Data	Aktiviteti
1	14-Mars	“Dita e veres”
2	20- Mars	“70-vjetori brigades se 7 sulmuse”
3	29- Mars -30 Mars	“Ura e Gorices flet”
5	11- Prill	“Fantastik SHOË” varjete numra shpejtesie
6	16-Prill	Koncert ne Kukës i grupit qytetare Berati ne perkujtim te eksodit Kosovar
7	19- Prill	“Shtepia prej debore” teatri kukllave
8	5-Maj	Dita e Deshmoreve ekspozite dhe koncerte me orkestren simfonike
9	8-Maj	Komedi e Dario Fo monolog nga Arben Derhemi
10	9-Maj	Happy Europe Day bashkepunim me DAR
11	13-Maj	“Kaposh koke boshi” teatri kukllave
12	29-30 Maj	Festivali 43 I femijeve
13	11 Qershor	“Friends” koncert me instrumentist te tunxhit Prof. I UA Sokol Saraci
14	12 Qershor	“Fresk Fare” film nga Leonard Bombaj
15	18-Qershor	Koncert ne shesh ne bashkepunim me QKF.
16	21 Qershor	Dita Nerkombetare e muzikes
17	23 Qershor	Teatri kukllave ne Pogradec
18	24 Qershor	Koncert me rastin e marrje se Statusit si vend kandidat ne BE
19	26 Qershor	Dita Nderkombetare kunder droges (aktivitet sensibilizus orkestra simfonike)
20	2-3 Korrik	Miss & Mister baby
21	8- Korrik	Grupi kenges qytetare Koncert ne 6-vjetorin e Beratit ne UNESCO
22	30-Korrik	Koncert pershendetes me rastin e zhvillimit te seminarit te 10 ne qytetin e Beratit nga dy Ministrit shqiptare e Kosovare
23	5-12 Gusht	Kinema verore me filma per femije te dubluar shqip per femijet e qytetit (lulishtja e bibliotekes)
24	22-23 Gusht	Koncert I gjithe potencialeve te qendres kulturore ne aktivitetin multi kulturore
25	27- Gusht	aktivitet sensibilizus ne bashkepunim me qendren rinore
26	13 Shtatori	Clirimi I qytetit (tirptik kulturore)
27	8 Tetor	Aktivitet me grupe folklorike te qarkut Berat
28	12-Tetor	Aktivitet me rastin e inagurimit te pedonales
29	28 –Tetor	Komedi “Jashte bie bore”
30	30 - Tetor	35- vjetori I Grupit Karakteristik I Kenges Qytetare
31	4- Nentore	Koncert me rastin e 70-vjetorit te gruas antifashiste
33	22-Nentor	Performance e kuartetit te Qendres Kulturore (Shqiperia jo duhanit)
34	25-Nentor	Konkurrimi I Grupit te Kenges Qytetare ne Elbasan



BASHKIA BERAT

35	25-Nentor	Montazh letrar artistik bashkepunim me shkollen 9-vjecare “Llambi Goxhomani”
36	28-29 Nentor	Aktivite per Pavarsine ne 102 vjetorin e saj dhe Clirimi i Atdheut nga okupatori fashist

Galeria e Arteve “Edëart Lear” .

Aktivite te zhvilluara nga Galeria “Edëard Lear”

Nr.	Data	Ekspozitat	Veprat	Autor	Vizitor	Të huaj	Nx. shkolle	Shuma
1	17 janar	“Hijet e Bardha” nga 21 shtete	225	138	130	15	45	190
2	14 shkurt	“Ditët e Kulturës Iraniane në Berat”	67(foto)		70	-	-	70
3	29 mars	“Ç’farë mërmërisin ujrat”	31(foto)	16	20	40	-	60
4	30 mars	“Koloni arti” me piktorët ballkanas pikturojnë Urën e Goricës	21	10	60	15	-	75
5	7 prill	Ekspozitë e fëmijëve të kopshteve Berat’Pranvera me ngjyra, fëmijë të gëzuar”	370 punime	11 kopshte 110 fëmij	-	4	105	109
6	10 maj	Ekspozitë personale Abaz Hado	62	1	64	6	-	70
7	22 maj	Ekspozitë personale e piktorit Arben Koliçi	46	1	61	-	-	61
8	6 qershor	Ekspozita e fëmijëve “Kolor 2014”	293	150	67	42	451	560
9	30 korrik	Ekspozita personale “Pleint-air 2014” e piktorit Agron Polovina	23	1	115	24	-	139
10	22 gusht	Ekspozita Artistet e qytetit ne fondin e Galerise “Pleint-air nga Ballkani, Agron Polovina”	71	38	93	135	-	228
11	13 Shtator	Ekspozita “Me krijuesit beratas” me rastin e 70 vjetorit te çlirimit ter Beratit.	37	18	66	6	-	72
12	30 Shtator	Ekspozita “Te perballesh me klimen”						
13	20 Tetor							
14	28 Nentor	Ekspozita “Edëard Lear 2014” edicioni tetembdhjete						
Shuma vjetore			1246	383	746	287	601	1634

Biblioteka “V.Buharaja”

Ka funksionuar per vitin 2014 si strukture brenda Qendres Kulturore “Margarita Tutulani”, me mision mirembajtjen e fondit te bibliotekes dhe shtimin e numrit te lexuesve per te gjithë grupmoshat, duke synuar shtimin e fondit te materialeve te bibliotekes, zhvillimin e aktivitetve promovuese e nxitesë ne funksion te shtimit te lexuesve e kryesisht atyre te rinj ne funksion te promovimit kultures dhe edukimit.



BASHKIA BERAT

Aktivitetet te zhvilluara nga Biblioteka "Vexhi Buharaja"

Nr.	Data	Aktiviteti
1	14- Shkurt	Konference me intelektuale per "Ditët e Kulturës Iraniane në Berat"
2	15-16 Maj	Promovim I vlerave profesionale te programit Cobiss.al ne bashkepunim me biblioteken e Akademise se Shkencave dhe institutin Slloven Izum
3	21 Maj	Takim me nxenes krijues te gjimnazit "B.D.Karbunara" mesuesit K.Boci dhe A.Laska
4	16- Qershor	Promovimi I librit me krijimtari poetike "Im ate" te autorit Harallamb Kota
5	16-Korrik	Seminar profesional ne bashkepunim me biblioteken e Akademise se Shkencave ne Tirane ne kuadrimin e projektit Cobiss.al
6	25-Shtator	Promovimi i salles se Hapsires Kulturore italiane ne biblioteke.
7	25-Shtator	Prezantim i muzikes arbereshe me kengetaret L.Stabile dhe C.Pellicano
8	25- Shtator	Takim me prof. Camillo Trapuzzano te shoqates arbereshe "Hydria" me teme "Aktualiteti kulturor I arberesheve te italise"
9	20 - Tetor	Takim me poeten Mimoza Hysa dhe perkthyesen Luljeta Lleshanaku
10	24-Tetor	Promovimi I librit "Prometeu ne Shqiperi" I studjuesit Italian prof. Mauro Geraci bashkepunim me IICT
11	4-Nentor	Takim prezantues per frankofonine ne bashkepunim me Aleancen Franceze ne Berat
12	6-Nentor	Promovimi I librit te Orhan Frasheri "Udhetim permes plumbave"
13	27-Nentor	Aktivitet me rastine 70-vjetorit te clirimit, shfaqje e filmit artistic Rus "Fati i njeriut" ne bashkepunim me shoqaten e miqesise Rusi-Shqiperi ne Berat

Klubi i shumespoteve "Tomorri".

Pershkrimi i programit. Masivizimin dhe konsolidimin e sistemit sportiv në dobi të shëndetit të shoqërisë sonë që nga fëmijët e kopshteve, të rinjtë, studentët dhe të rriturit.

Edhe per vitin 2014 ka funksionuar si strukture brenda Qendres Kulturore "Margarita Tutulani", me mision nxitjen, zhvillimin dhe përhapjen e kulturës sportive në qytet, nëpërmjet organizimit të projekteve sportive dhe pjesëmarrjes ne aktivitetet kombetare dhe nderkombetare.

Objektivi: Rritja e cilësisë sportive te të rinjve pjesëmarrës në ekipe të llojeve të ndryshme të sportit, si ping pongut, bilardos, basketbollit, gjimnastikes, mundjes, boksit, karates, peshengritjes, futbollit të ngritura pranë klubit te ShumSPORTIT.

Arritja e sukseseve kombëtare dhe ndërkombëtare të ekipit ping pongut, mundjes, karates, boksit dhe sporteve te tjera, me gjithë financa te kufizuara ky klub ka arritje e suksese kombëtare dhe ndërkombëtare.

Klubi i shumespoteve "Tomorri" realizoj aktivitetet e listuara ne buxhetin e vitit 2014, ku e vecanta e ketij viti ishte likuidimi I borxheve dhe debive te krijuara ne lidhje me pagesat e trajnierreve dhe sportistevet te Klubit te ShumSPORTIT, trajtimet ushqimore te sportistave dhe trajnierreve, dhe aktivitetet e zhvilluara.



BASHKIA BERAT

Aktivitetet e zhvilluara nga Klubi i Shumesporteve “TOMORRI”

Nr.	Lloji i sportit	Aktiviteti
1	Boks	Berat, me 12.06.2014 Kampionati Kombetar 12-13 vjec Vlore, me 10.09.2014 Kampionati Kombetar 17-18vjec Tirane, me 25.09.2014 Kampionati Kombetar te rritur
2	Peshengritje	Elbasan, me 26.03.2014 Kampionati Kombetar U13 dhe U17 vjec Tirane, me 20.09.2014 Kampionati Kombetar per te rritur
3	Mundje	Tirane 02.05.2015 Kupa e Shqiperise per shkolllore ,para te rinj dhe te rinj Durres. me 07.06.2014 Kupa e Republikes Tirane, me 15.11.2014 Kampionati Kombetar per te Rritur
4	Pingpongu	Shkoder, me 10.05.2014 Kampionati Kombetar per parate rinj(f+m) Shkoder, me 08.06.2014 Kampionati Kombetar per te rinj (f+m) Elbasan, me 06.07.2014 Aktiviteti seleksionues per te perzgjellur sportistet pjesmares te Ballkaniades (f+m) Tirane, me 21.09.2014 Kampionati Kombetar per te rritur ekipor(m+f) Tirane, me 05.10.2014 Kampionati Kombetar Individual per te rritur Shkoder, dhjetor Kupa e Shqiperise per te rritur (m+f)
5	Gjymnastike	Tirane, me 14.06.2014 Kampionat Kombetar para te rinj, te rinj dhe te rritur Tirane, me 04. 10. 2014 Kupa e Shqiperise
6	Basketbolli	Tirane, me 06.07.2014 Kupa Rinia
7	Karate	Tirane, me 06.07.2014 Kupa Rinia
8	Alpinizem	Tirane , me 06.07.2014 Kupa Rinia

Qendra Kulturore me gjithë aktivitetet e saj si Qender, te Bibliotekes “V.Buharaja” Galerise se Arteve “Edëart Lear”, te Klubi i shumesporteve “Tomorri”, mbylli vitin buxhetor 2014 pa detyrime.

VI. KF TOMORRI 1923 sh.a.

KF TOMORRI 1923 sh.a. eshte financuar nga bashkia ne masen 100% te nivelit te planifikuar, ne shumen 16 500 000 leke, kundrejt 12 975 000 leke, ne vitin 2013, si dhe jane siguruar te ardhura nga biletat ne shumen 200 000 leke. Totali i te ardhurave te perdorura eshte 16 700 000 leke. I gjithë fondi eshte konsumuar ne baze te planit financiar te sh.a, ku 60 % te buxhetit ose ne vlere absolute prej 10 000 000 leke e perben zeri paga dhe sigurime shoqerore te totalit te shpenzimeve prej rreth 16 700 000 leke, 9.6% e zene shpenzimet e trajtimit ushqimor dhe te djetave te sportistevë, pjesen tjetër prej 30.4 % te totalit te shpenzimeve e perbejne shpenzime te tjera operative, si faza pergatitore, uniforma, shpenzime per ilace etj.,

Perdorimi i fondeve konform legjislacionit e ne perputhje me **statusin e** tij, mbetet nje nga sfidat e rendeshishme te funksionimit te KF TOMORRI 1923. Sh. A. Kjo shoqeri e mbylli vitin buxhetor me detyrime te delkaruara ne shumen prej 20 105 940 leke, si me poshte:

- ❖ Kuote pjesmarrje ne kampionat, shuma 1400 000 leke,
- ❖ FIFA (ceshtje Jurika Vrucina), shuma 1300 000 leke,
- ❖ Shpenzime gjyqesore (Subjekti Palma Berat), shuma 1400000,



BASHKIA BERAT

- ❖ Detyrime ndaj O.S.Sh.E., shuma 2160000leke,
- ❖ Ujesjelles kanalizime, shuma 884 880 leke,
- ❖ Detyrime ndaj Drejtorise Rajonale Tatimeve Berat, shuma 7 000 000 leke.
- ❖ Paga e muajit nentor(personeli ,trajnier, futbollist), shuma 1 000 000 leke.
- ❖ Detyrime firmes “Florion” sh.p.k. 3 000 000 leke.
- ❖ Detyrime Hotelerie , shuma 558 000 leke
- ❖ Detyrime furnitoresh, shuma 1053 000 leke

PROGRAMI I STREHIMIT DHE MENAXHIMIT TE BANESAVE SOCIALE ME QERA

Pershkrimi i programit. Ky program ka per qellim ti vije ne ndihme familjeve ne nevoje per subvencionim e qerese per keto familje sipas nenit 24 te Ligjit nr. 9232 date 13.05.2004 “Per programet sociale per strehimin e banoreve te zonave urbane”, ndertimin e nje pallati me 24 apartamente me bashkefinansues Entin Kombetar te Banesave, duke kontribuar me truallin qe do te perdoret per ndertimin e ketij objekti, vazhdim i pjesmarrjes ne projektin “Per subvencionimin e kredive me interesa te zbutura zbatuar nga M.P.P.T.

Politika e programit. Politika e ketij programi konsiston ne ardhjen ne ndihme te familjeve ne nevoje si nepermjet dhenies se bonusit te strehimit per subvencionin e qerave t e familjeve ne nevoje, pjesmarrjes ne projektin “Per subvencionimin e kredive me interesa te zbutura” zbatuar nga M.P.P.T

Njësiti shpenzuese

- **Bashkia Berat**
- **Enti Kombetar i Banesave**

Objektivat e programit

- Menaxhimi i 48 apatameneve te banesave sociale me qera.
- Perfshirja ne skeme e familjeve qe perfitojme bonus strehimi.
- Perfshirja ne skeme e familjeve qe perfitojne nga subvencionin e kredive me interes te zbutur, projekt i zbatuar nga M.P.P.T.

Ne lidhje me menaxhimin e banesave sociale me qera admin strohen 48 kontrata qeraje , dhe 7 kontrate qeraje te entit kombetar te banesave. Per mirembajtjen e tyre jane konsumuar 205564 leke, 29 703 leke per interesa depozite , dhe gjendja financiare e llogarise se posacme te hapur me VKB , deri ne daten 10.12.2014 eshte 13 625 488 leke. Me daten 19.12.2014 do te kemi shlyerjen e keshtit te pare te kredise CEB per ndertimin e banesave sociale me qera, ne Shumen 18700 euro, e cila nuk do te prek buxhetin e bashkise, por do te shlyhet nga te ardhurat e qerese te ngurtesuara ne llogari te posacme sipas dispozitave ne fuqi.

PROGRAMI I KUJDESIT SOCIAL

a. Trajtimi financiar i personave me aftesi te kufizuar, me ndihme ekonomike si dhe “Raste te vecanta”

Pershkrimi i Programit. Ky program ka per qellim ti vije ne ndihme personave me aftesi te kufizuar, trajturesve te ndihmes ekonomike si dhe te perfshije ne skemen e ndihmes ekonomike familje te cilat nuk permbushin kriteret per te perfitur nga legjislacioni ne fuqi.Pasi gjykohen arsyet pse familja nuk mund te perfshihet ne skeme dhe pasi behet



BASHKIA BERAT

verifikimi i gjendjes social-ekonomike te familjes drejtoria e sherbimeve sociale vendos nese familja mund te trajtohet si rast i vecante dhe te mbeshtetet nga fondet e bashkise.

Politika e programit.

Trajtimi i familjeve ne nevoje me ndihme ekonomike , pagesa e papftesise per personat me aftesi te kufizuar (me fonde te buxhetit te shtetit) si dhe trajtimin si “raste te vecanta”, qe do te mundesoje vleresimin financiar te ketyre familjeve (me fondet e bashkise) duke kontribuar ne rritjen e te ardhurave te familjes.

Njësitë shpenzuese

- **Bashkia Berat**
- **Buxheti i Shtetit**

Objektivat e programit.

Perfshirja ne skeme e individeve/grupeve te percaktuara me ligj si dhe trajtimi si “Raste te vecanta” e individeve/grupeve te perjashtuara nga ligji.

Produktet u realizuan: Numri i familjeve në skemën e ndihmes ekonomike qe trajtohen me fondet e buxhetit te shtetit jane mesatarisht 926 trajtues per vitin 2014 (muaji i fundit rezulton me 850 familje te trajtuara) , Trajtuesit e ndihmes ekonomike per vitin 2014 te ndare me rajone jane respektivisht si me poshte: Rajoni Nr.1, 308 familje, Rajoni Nr.2, 288, Rajoni Nr.3, 255 familje, Rajoni, Nr.4, 75 familje, Nga keto jane trajtuar me ndihme te plote 860 familje, me ndihme te pjesshme 66 familje. Perfitues nga skema e ndihmes ekonomike jane 59 familje te komunitetit rom.Kane perfituar ndihme ekonomike 10 familje qe kane ne perberjen e tyre persona me aftesi te kufizuara (PAK). Nga fondet e buxhetit te bashkise jane trajtuar : 19 familje si raste te vecanta me nje fond 980 mije leke , te cilat u perkasin grupeve me vulnerable qe nuk permbushin kriteret per te perfituar nga ligji i ndihmes ekonomike. Persa i takon mases se ndihmes ekonomike eshte mjaft e ulet, keshtu nje familje perfiton mesatarisht ne muaj 3367 leke, sasi e pamjaftueshme per te perballuar nevojat minimale. Gjate vitit 2014 bashkia ka trajtuar me fonde te Buxhetit 2265 persona me aftesi te kufizuara. (PAK).

a. **Funksionimi i Qendrave Rezidenciale**

Pershkrimi i programit. Ne bashkine Berat funksionojne 2 qendra rezidenciale per persona me aftesi te kufizuar dhe qender ditore me 45 kliente rezident e 20 femije ditor. Qendra “Une jam si Ju” qe trajtohet financiarisht nga fonde te buxhetit te shtetit, dhe “Lira” qe trajtohet financiarisht nga Transferata e pakushtezuar, qe I akordohet bashkise sipas ligjit te buxhetit. Ne keto qendra ofrohen sherbime per riaftesimin fizik, psikik dhe edukativ te klienteve.

Politika e programit .Ngritja e kapaciteteve per te perballuar kerkesat. Rritja e sherbimeve dhe kualifikimi i punonjesve qe u sherbejne personave te paafte kliente te qendrave.Rikonstruksione te ndertesave ekzistuese.

Njësitë shpenzuese

- **Bashkia Berat**
- **Buxheti i shtetit**
- **Donatore**



BASHKIA BERAT

Qendra “Lira”.Ka funksionuar per vitin 2014 me nje presonel prej 18 punonjesish me objekti ofrimin e sherbimeve per riaftesimin fizik, psikik dhe edukativ te PAK.

Pasqyra nr. 23

Realizimi i shpenzimeve per Qendren “Lira”

në 000/lek

Emertimi i shpenzimit	Plani 2014	Fakti 2014	Realizimi ne %
Paga	9 949	8 695	87.3
Sigurime shoqerore	1 662	1 352	81.3
Shpenzime operative	6 140	4 139	67
Totali i shpenzimeve	17 751	14 186	80

Shpenzimet ne total jane realizuar ne masen 80 %, mosrealizimi ne masen 3 565 000 leke, kundrejt realizimit 78% me vitin 2013.

Zeri **paga** dhe **sigurime shoqerore** eshte realizuar ne masen 87.3 %, dhe **81.3%** duke mos krijuar deficit.

Realizimi ne masen 78% mosrealizimi ne masen 1080000 leke I shpenzimeve operative, ne vitin 2013, ndersa ne vitin 2014 ne masen 67%, kundrejt 66% te shpenzimeve operative, ne vitin 2012.

Qendra “Lira” ne perfundimin e vitit buxhetor rezulton me detyrime te palikujduara ne Shumen 1 000 000 leke.

Objektivat e programit;

- Sherbimet e ofruara per klientet kane per qellim riaftesimin psiko- socio-edukativ te standartizuar, per nje jetese te pavarur ose autonome per personat me aftesi te kufizuar mendore e fizike.
- Sherbimin ortofonik dhe logopedik qe synon permiresimin e komunikimit te klienteve
- Sherbimi i fizioterapise per riaftesimin psiko-motor te klienteve me aftesi te kufizuar fizike.
- Sherbimi i ergoterapise nepermjet mini-projekteve te organizuara nga edukatoret dhe klientet e Qendres.
- Sherbimi mjekesor nepermjet mjekut me part-time dhe infermierit me kohe te plote.
- Sherbimi administrative nepermjet personelit ndihmes.

INVESTIMET PUBLIKE

Per Bashkine Berat Viti 2014 eshte vit sukcesi ne perftimin e investimeve publike, duke shenuar vitin me te mire ne perthithjen e fondeve nga Komiteti i Zhvillimit te Rajoneve.

Investimet e perfutuara ne bashkine Berat (te prokuruar nga bashkia) gjate vitit 2014, u financuan nga:

- Te ardhurat e bashkise ne shumen 65 630 183 leke ose 21 % te totalit te investimeve.
- Investime nga Komiteti i Zhvillimit te Rajoneve ne infrastrukture ne shumen 188 416 556 leke ose 60 % te totalit te investimeve.
- Investime nga Komiteti i Zhvillimit te Rajoneve ne Arsim ne shumen 42 015 881 leke ose 13 % te totalit te investimeve.

Gjate vitit 2014 ne zbatim te buxhetit te miratuar me VKB si dhe fondet e akorduar nga Fonde per Zhvillimin e Rajoneve , jane realizuar procedurat e prokurimit elektronik ne vleren prej 422 674 669 leke nga te cilat:



BASHKIA BERAT

- a) pune civile 357 700 721 leke (fonde te investimeve)
 b) furnizime 9 408 264 leke (furnizime me ushqime, kopshte, cerdhe, konvikte, blerje karburanti)
 c) sherbime 55 565 684 leke (sherbimi i pastrimit te qytetit, lysterja e institucionet shkollore etj.)

a. Investimet nga **burime te veta** per vitin 2014 u planifikuan ne shumen 78 291 000 leke, ose 17% e buxhetit ne total , shifer kjo e konsiderueshme ne raport me vitin 2013, dhe ne fakt u realizua 65 630 183 leke. Me **burime te veta** per vitin 2014 u likujduan:

I. Detyrimet e vitit 2013:

- Likujdimin pjesore (deri ne 50%), te detyrimeve financiare per prokurimet e kryera me vlere te plote ne vitin 2012 dhe te likujduara pjeserisht.
- Vazhdimin e likujdimit te vleres se plote per investimet e pafinancuara me buxhetin e vitit 2013.
- Vlerat e kontratave te mbikqyrjes dhe te kolaudimit te te objekteve ne infrastrukture, (detyrime te mbartura nga vitet e meparshme).

Investime te programuara e te realizuara per vitin 2014 nga Burime te veta paraqiten sipas pasqyres se meposhtme.

Grupi 00 (teprica neto operative, te ardhurat e Bashkise)						
INVESTIME NE PROCES NGA VITI 2013					38,870	31,007
Prog	Kap	Art	Emertimi	Plan Buxheti	Totali	
4530	5	231	Rivesh. Asf.Karb. Hasani Ura Gorice	5,170	5,170	
4530	5	231	Furn. me beton "Rivit. Shet. Republika Sh. T.Muzaka"	14,760	13,579	
4530	5	231	Mbikq. Trot Antipatrea ish Diviz-Ura Uznove	282	282	
4530	5	231	Rik Trot Antipatrea ish Diviz. Ura Uznove	9,636	9,636	
4530	5	231	Mbikq. Rruga Antipatrea Karb Hasani Ura Gorice	110	110	
4530	5	231	Sup. Sist. Asf. AXH. Th. Tani Suelas Sheshi Vakef	50	50	
4530	5	231	Rikonstruksion. Trot. Antipatrea ,Kisha Sh.Dhimiter-Markate	2,131	2,131	
4530	5	231	Kolaud. Rik.Trot.Antipatrea Ish Diviz-Ura Uznove	21	21	
4530	5	231	Kolaud. Riveshje e shtr. Asf.Antipatrea Karb. Hasani-Ura e vjeter Gorice	26	26	
4530	5	231	Rehabilitim I hapesires urbane L. M. Celebiu ALUIZNI	6,455		
4530	5	231	Mbikqyrje punimesh Rehab. Gaps. Urbane L. M. Celebiu ALUIZNI	227		
INVESTIMET E VITIT 2014					43,669	34,622
Prog	Kap	Art	Emertimi	Plan Buxheti	Totali	
1110	5	231	Pajisje	2,450	1,120	
4530	5	231	Furniz. me gure "Rivit. I Shetitores. Republika, Sh. T. Muzaka"	30,594	30,142	
6260	5	231	EPER Center per "Shkollen ekologjike"	375	375	
6260	5	231	Hidroizolim I ndertesës ne V. e Deshmoreve	265	265	
6260	5	231	Sist. I shteses ne varrezat Burdullias	625	613	
6260	5	231	Mbikqyrje Sist. I sht. Varrezat Burdullias		11	
4530	5	231	Kolaudim "Sistemimi i shteses ne varrezat Burdullias"		5	



BASHKIA BERAT

6260	5	231	Investime Ndermarrja e Gjelberimit	474	462
9120	5	231	Mobilim I kopeshtit te Qendres Komunitare Rome	500	500
8140	5	231	Rikonstruksion I shkalleve te tribunes se stadiumit "Tomori"	480	374
8250	5	231	Investime Qendra Kulturore	1,440	753
9230	5	231	Investime Qendra Ekonomike e Arsimit	2,500	100
4530	5	231	Supervizime Rivitalizim I parkut perendimor te qendres, Rikonstruksion I shetitores Osumi	3,060	-
4530	5	231	Riveshje asfaltike seg Ura e Gorices-Kisha e Shen Merise	905	
			Totali I investimeve nga te ardhurat e Bashkise	82,540	65,630

Ne vitin 2014 u realizua me sukses **Projekti “Studim-projektim i Bulevardit kryesor “Republika” dhe rehabilitimi i sheshit “Teodor Muzaka”**, eshte pjese e Strategjise se Qytetit per Zhvillimin Social Ekonomik 2010-2020 te vendimuar ne Keshillin Bashkiak, mbi bazen e **nenshkrimin e mareveshjes** se bashkepunimit ndermjet Bashkise Berat dhe Fondacionit Shqiptaro-Amerikan per Zhvillim. Ky projekt perfshiu nderhyrjen ne zonen qendrore te qytetit dhe rehabilitimi i tij i dha zones se Qendres se Qytetit pamje dinjitoze ne perputhje me kriteret e zones tampon.

Fondacioni Shqiptaro-Amerikan per Zhvillim kontribojte me shume rreth 1 200 000 US\$ per rikonstruksionin e bulevardit kryesor “Republika” dhe rehabilitimi i sheshit “Teodor Muzaka” sipas preventivit perkates te projektit).

Bashkia Berat financoj ne shumen 14 760 000 leke, per rikonstruksionin ne Bulevardit kryesor “Republika” dhe sheshin “Teodor Muzaka” Funizim me beton, si dhe zerin Funizim me pllaka guri natyror, ne shumen 30 594 528.

Shtese ne planin e investimeve te vitit 2014.

1. Sistemimi i shteses se varrezave publike ne Burdullias ne shumen 642 251 leke.

Duke e vleresuar si nevojte emergjente te sherbimit ndaj komunitetit zgjerimin e varrezave publike ne Burdullias, si dhe me konfirmimin e statusit juridik te pasurise nr 4/78 (klasifikohet toke truall), ndodhur ne zonen kadastrale 8501 Berat, me indeks HTR BR- D – 4. Parcela e cituar me siper ndodhet ne hyrje te Qytetit te Beratit, rreth 250 – 300 m large rruges nacionale e ne zonen suburbane te qytetit ne afersi te ish zones industrial. Kjo parcele eshte ne vazhdimesi te varrezave ekzistuese rreth 1500 m2. Fondi per sistemimin e varrezave publike ne Burdullias u sigurua nga alokimi I fondeve te vet bashkise. VKM nr.198 dt 03.04.2014 “Per percaktimin e shumave te shuarjes me kompensim te detyrimeve te enegjise elektrike, ndermjet Institucioneve buxhetore dhe jobuxhetore qe financohen nga Buxheti”, miratoj shuarjen me kompensim nga Ministria e Financave te detyrimeve n daj energjise elektike, te krijuara deri me daten 31.12.2013. Bashkia Berat (Ndermarrja Rruge Troruare), perfitoi nga ky Vendim ne shumen 4 351 748 leke. Per kete fond me VKB nr. 25 date 28.05.2014 u miratua destinacioni i perdorimit te tij.

2. **Per supervizimin e objekteve;** Ne fondet e akorduara per “Rikonstruksion i shetitores se bulevardit “Osumi”, dhe “Rivitalizimi i parkut perendimor te qendres dhe nenkalimi i unazes perimetrale” nga Komiteti i Zhvillimit te Rajoneve, nuk perfshihet vlere e surevizimit, ato jane detyrim i bashkise. Ne baze te VKM 444 , sipas perllogaritjeve rezulton se : per objektin “Rivitalizimi i parkut perendimor te qendres dhe nenkalimi i unazes



BASHKIA BERAT

perimetrale” vlera e supervizimit ze 1200 000 leke dhe per objektin “Rikonstruksion i shetitores se bulevardit Osumi” vlera e supervizimit ze 1842481 leke, ne zbatim te procedurave te prokurimit elektronik rezultuan vlerat perkatesisht: 237600 leke, dhe 350400 leke.

b. Investime nga Komiteti i Zhvillimit te Rajoneve ne infrastrukture.

Perfitueshmeria nga Grandet Konkruuese pare ne dinamike kane tendence renie dhe nga viti 2010 e ne vazhim nuk eshte investuar ne asnje prioritet zhvillimi te ekonomise te projektuar ne Dokumentet Strategjik.

Viti 2013 shenon vitin 0 persa i perket perfitueshmerisë nga garandet konkruuese.

Ne vitin 2014, Bashkise Berat, ne zbatim te Vendimit nr. 2 date 9.04.2014 te Komitetit te Zhvillimit te Rajoneve “Per shperndarjen e fondit per infrastrukturen vendore”, i jane akorduar fonde per objektin “Rikonstruksion i shetitores se bulevardit Osumi”, ne vleren e plote te projektit prej 163 557 180 leke dhe financim i vitit 2014 ne shumen 110 925 598 leke, dhe “Rivitalizimi i parkut perendimor te qendres dhe nenkalimi i unazes perimetrale” ne vleren e plote te projektit prej 163 557 180 leke dhe financim i vitit 2014. Rehabilitimi i fasadave pergjate bulevardit kryesor me vleren e plote dhe vleren pjesore per vitin 2014 ne shumen 7 097 244 leke.

Ne vlerat e mesipeme nuk perفشihet vlera e supervizimit, ato jane detyrim i bashkise.

c. Investime nga Komiteti i Zhvillimit te Rajoneve ne Arsim.

1. Ndërtimi i tre fushave sportive polifunkionale në amjentet e shkollave Ajet Xhindole, shkolla 28-Nëntori dhe shkolla Xhemal Cekini” Berat (I ndarë në tre lote)

Per kete objekt prokurimi eshte lidhur kontrata e siper marrjes ne date 08.09.2014 ndermjet Bashkise Berat dhe “Beqiri & Sardo” shpk. Vlera e kontratës është 7 424 400 lekë vlera e plotë dhe 4 684 440 lekë vlera pjesore për viti 2014. Investimi eshte i shtrire ne dy vite buxhetore 2014-2015. Afati i punimeve eshte 90 dite kalendarike. Mbeshtetur ne afatin e kontrates se nenshkruar dhe ne ritmin e punimeve parashikohet qe punimet te mbarojne brenda vitit 2014.

2.“Rikonstruksion i Shkolles se Mesme “K.Capo” Berat

Edhe per kete objekt prokurim eshte nenshkruar Kontrata e siper marrjes ndermjet paleve Bashkia Berat dhe “Aurora Konstruksion & BE-IS ” Sh.p.k, me daten 10.09.2014 me **26 225 240** lekë me tvsh , vlera e plotë dhe **11 996 164** lekë me tvsh vlera pjesore për viti 2014. Investimi eshte I shtrire ne dy vite buxhetore 2014-2015. Afati i punimeve 150 dite, punimet jane ne proces.

3.“Rikonstruksion i Shkolles 9 –vjecare “Th.Tani” Berat

Kontrata e siper marrjes ndermjet paleve Bashkia Berat dhe “Besta_” Sh.p.k eshte nenshkruar ne date 01.10 .2014 me shumen **24 334 872** lekë me tvsh , vlera e plotë dhe **11 420 976** lekë me tvsh , vlera pjesore për viti 2014. Afati i punimeve 150 dite. Investimi eshte I shtrire ne dy vite buxhetore 2014-2015. Edhe per kete objekt kontrate, Punimet Jane ne proces.



BASHKIA BERAT

Pasqyra nr. 24


Investimet nga Grantet Konkruese (Komiteti i Zhvillimit te Rajoneve) ne vite

në 000/lek

Vitet	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Vlera	108,280	14,908	67,696	29,568	72,218	19,334	0	197,350

Grafiku nr. 17

Investimet nga Grantet Konkruese ne dinamike ne vite



Pasqyra nr.25

Investimet nga Komiteti i Zhvillimit te Rajoneve per vitin 2014.

INVESTIME NE INFRASTRUKTURE					
Prog	Kap	Art	Emertimi dhe vlere e plote e projektit	Plan	Totali
4530	1	231	Rivitalizim I parkut perendimor te qendres	69,375	69,375
4530	1	231	Rikonstruksion I shetitores Osumi	110,925	110,925
			Totali I investimeve ne infrastrukture	180,301	180,301

INVESTIME NE ARSIM					
Prog	Kap	Art	Emertimi dhe vlere e plote e projektit	Plan	Totali
9230	1	231	Rikonstruksion I shkolles se mesme "K. Capo"	11,996	11,996
9120	1	231	Rikonst.Shkolla "Thimi Tani"	11,420	11,420
9120	1	231	Fusha sportive shkolla "A. Xhindole", "28 Nentori", "Xh. Cekini"	4,684	3,630
			Totali I investimeve ne arsim	28,101	27,047



Auditimi - instrument i rendesishme per menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Drejtoria e Auditimit te Brendshem duke qene pjese e struktures organizative te Administrates se Bashkise me vartesi direkte te Titullari te Institucionit ndjek dhe zbaton procedurat qe parashikohen ne ligjin Nr.9720,date 23.04.2007 “Per auditimin e brendshem ne sektorin publik”,te ndryshuar , udhezimin nr 12 date 05.06.2012 “Mbi procedurat e kryerjes se veprimtarise se adutitit te brendshem ne sektorin publik” dhe ligjin 10296 date 08.07.2010 “Per menaxhimin finaciuar dhe kontrollin” .

Misioni i Auditit te Brendshem ne Bashkine Berat eshte te permiresoje performancen e veprimtarise se institucionit te Bashkise dhe njesive shpenzuese qe varen prej saj duke ofruar sherbime keshillmore cilesore dhe gjykim profesional per te siguruar perdorimin me dobi, kursim dhe frytshmeri te fondeve publike ne realizimin e sherbimeve qe ofrohen.

E fokusuar ne baze te nje plani vjetor dhe strategjik per te audituar konform legjislacionit ne fuqi, drejtoria ka ndjekur me perparesi dhe prioritet zbatimin e ligjit,

Duke njohur gjithe strukturen e Bashkise, sistemet apo fushat me risk te saj, per nje plan auditimi sa me efektiv dhe cilesor orientimi kryesor ka qene mbi:

- ✓ **Sistemin e manaxhimit financiar** (si sistemi i kontabilitetit, i pagesave, i te ardhurave, i prokurimeve etj)
- ✓ **Sistemin e perputhshmerise**, pagat, auditim i pergjithshem i tyre, perputhja me VKM, bazueshmeria e tyre ne ligj. prokurimet, planifikimi i shpenzimeve per to, perputhshmeria e procedurave,dokumentacionit me legjislacionin perkates.
- ✓ **Sistemin e performances** (realizimi i te ardhurave dhe ndjekje te zbatimit te buxhetit ,respektimi i afatit ligjor per sherbimeve te ofruara).
- ✓ **Ndjekjen e zbatimit te rekomandimeve** (Zbatimi ne afat i rekomandimeve sipas plan veprimit te subjekteve te audituara, dokumentimi dhe auditimi i realizimit te rekomandimeve.raportimi periodik sipas plan veprimit dhe afateve i realizimit te rekomandimeve)

Jane audituar te gjitha njesite shpenzuese ne varesi te Bashkise Berat sikurse edhe disa drejtori brenda struktures se Bashkise Berat. Gjate vitit 2014 jane realizuar 14 kontrole, jane dhene 42 rekomandime nga ku jane evidentuar 8 shkelje dhe jane propozuar 3 masa administrative e financiare.

Kane marre pergjigje e eshte audituar cdo informacion i vleresuar me risk, permes kontroleve te plota dhe tematike. Vemendje maksimale ka marre auditimi i perputhshmerise,performances dhe financiar i ndermarrjes se Parkut te Udhetareve Berat dhe sherbimit te ofruar prej saj, qe vazhdon te jete jo efektiv duke mospermbushur objektivat ne lidhje me realizimin e ketij sherbimi me kursim, dobi dhe frytshmeri.

Ne perpjekje per te siguruar cilesi te sherbimit te transportit urban u pergatit materiali qe u vendimua ne keshill bashkiak me nr. 34 date 23.10.2014 per dhenien e miratimit te Bashkise Berat te zhvilloje procedurat per konkursin e hapur per linjat urbane qytetase.

Qartesimi i ligjit per auditin, kompetencat dhe detyrimet qe burojne prej tij ,kane qene pjese e kontrollit keshillues per cdo njesi shpenzuese dhe per me teper objekt i kontrollit profesional.

Disa nga objektivat e Drejtorise se Auditimit te Brendshem jane:



BASHKIA BERAT

- ✓ Të ndihmojë menaxhimin e Bashkise-se, në arritjen e qëllimeve dhe objektivave të tyre, duke përmirësuar sistemet dhe shërbimet që ofron ky institucion.
- ✓ Të japë siguri objektive tek menaxhimi i Bashkise-se mbi saktësinë dhe besueshmërinë e raporteve financiare dhe raporteve të performancës, të përgatitura nga strukturat e subjekteve.
- ✓ Kryerja e veprimtarisë së pavarur objektive dhe të bazuar në identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut.
- ✓ Të ndihmojë menaxheret e njësive shpenzuese për të qenë të përgjegjshëm ndaj detyrimeve ligjore, publikut, duke vlerësuar pershtatshmerinë dhe efektivitetin e sistemeve, strukturave, vendimeve, procedurave dhe kontrolleve, përputhshmerinë e akteve të brendshme, rregulloreve, urdhrave me legjislativonin përkatës.

Viti i ri financiar ka të tjera objektiva edhe me cilësore me një performancë në rritje dhe profesionalizem për të thelluar më tej auditimin mbi përdorimin e fondeve buxhetore duke minimizuar mundësitë për mashtrim, shpërdorim, abuzim dhe keqpërdorim.

KAPITULLI III

PLAN BUXHETI I VITIT 2015

Informacion i përmbledhur i plan buxhetit të vitit 2015

- ✓ Viti 2015 shënon një tjetër moment historik të decentralizimit dhe të autonomisë së pushtetit vendor. Zgjedhjet vendore të vitit 2015, shënojnë fillimin e qeverisjes vendore sipas ndarjes së re administrative-territoriale. Reforma e re territoriale do t'i kursejë buxhetit vendor rreth 6 miliardë lek shpenzime administrative, të cilat do të shkojnë për shërbime dhe investime publike në favor të komuniteteve.
- ✓ Ndarja e re administrative-territoriale, do të pasohet nga një reformë tjetër e decentralizimit fiskal. Me këto reforma synohet:
 - (i) demokratizimi i qeverisjes;
 - (ii) efienca në ofrimin e shërbimeve për qytetarët;
 - (iii) zhvillimi ekonomik lokal,
 - (iv) zhdukja e pabarazive dhe zhvillimi i qëndrueshëm.
- ✓ Buxheti i vitit 2015 garanton kalimin efektiv dhe eficient të kompetencave, përgjegjësi dhe të gjitha problematikave vendore nga të zgjedhurit aktual tek të zgjedhurit e rinj, sipas ndarjes së re territoriale. Në një aneks të veçantë të ligjit të buxhetit të vitit 2015 janë paracaktuar masat e nevojshme, rolet dhe detyrat përkatëse për periudhën tranzitore.
- ✓ Janë bërë disa përmirësime të tjera cilësore në formulën ndarjes së transfertës së pakushtëzuar për njësitë e qeverisjes vendore. Janë vendosur kritere dhe tavane që garantojnë funksionimin normal të të gjitha njësive të qeverisjes vendore.
- ✓ Në vitin 2015, me ndryshimin e ligjit për taksat kombëtare, të ardhurat nga renta minerare do t'i akordohen në mënyrë të drejtpërdrejt njësive të qeverisjes vendore.
- ✓ Specifikisht për vitin 2015, transfertat e pakushtëzuar do të vazhdojë të ndahet në 373 NJQV, sipas kritereve të mësipërme, por duke rifreskuar të dhënat për popullsinë, kapacitetet fiskale dhe tregues të tjerë të varfërisë.



BASHKIA BERAT


- ✓ Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, i provuar si një skemë financimi e suksesshme merr rëndësi akoma më të madhe në buxhetin e vitit 2015. Objektivat madhore të qeverisë për zbatimin e ndarjes administrative-territoriale dhe për rilindjen e qyteteve dhe të qendrave të tjera zhvillimore, gjejnë mbështetjen e plotë në skemën e financimit të investimeve nëpërmjet Fondit të Zhvillimit të Rajoneve.
- ✓ Rritja e konsiderueshme e fondit në këtë skemë bën që buxheti vendor të jetë më i madhi në historinë e tij.
- ✓ Buxheti vendor i vitit 2015, me tërë komponentët e tij (transfertë e pakushtëzuar, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, renta minerare dhe të ardhurat e veta) është 24.4 për qind më i lartë, si ai i vitit 2014, ndërkohë që shpenzimet e buxhetit të shtetit janë rritur vetëm 4%. Kjo rritje e buxhetit vendor me 20.4% më shumë se sa buxheti i shtetit, tregon rëndësinë që ka miratimi dhe zbatimi i reformës administrative-territoriale.

Deficiti buxhetor për vitin 2015 parashikohet të ulet në nivelin 4.0% të PBB nga 6.6% e PBB që ishte planifikuar në buxhetin 2014.

1. Struktura financiare e buxhetit 2015

